



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.04.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për miratimin e raportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:30 dhe mbaroi në orën 12:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Markelian Koça*** (anëtar)
9. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

10. Emona Muçi

(anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje, zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Ilir Rusi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Rezarta Taushani, Dorina Priifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 6. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.**
- 7. Edmon Hoxhaj, Birn.**
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtim i projektvendimit “Për miratimin e raportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e radhës, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Siç jeni në dijeni, në rendin e ditës janë rreth 14 çështje për të cilat kërkohet vendimmarrja e Këshillit. Nëse nuk kemi diskutime mbi rendin e ditës, atëherë unë do të propozoja që të fillojmë me çështjen e parë e cila pa diskutim është një çështje e rëndësishme që ka të bëjë me miratimin e Raportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor, veprimtarinë e KLGJ-së për vitin 2023.

Siç jeni në dijeni nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor janë miratuar katër raportet e komisioneve lidhur me veprimtarinë e komisioneve, por pjesë e raportit vjetor, përveç veprimtarisë së Këshillit që janë veprimtaria e komisioneve, ka të bëjë edhe me analizën e sistemit gjyqësor.

Në zbatim të ligjit të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, neni 82, ky raport pasi miratohet nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, i depozitohet Kuvendit dhe Kuvendi më pas bën një seancë dëgjimore me përfaqësues të Këshillit, ku Këshilli informon Kuvendin, jo vetëm mbi gjendjen e gjyqësorit, por gjithashtu artikulon edhe nevojat që ka sistemi dhe që Kuvendi mbart detyrimin për t'i plotësuar.

Raportin jua kam përcjellë. Është bërë nga një grup pune.

Pjesa e parë e raportit (po jap sqarime edhe për ata anëtarë që e kanë për herë të parë raportin e Këshillit), shkurtimisht janë: pjesa e veprimtarisë së komisioneve; më pas kemi të bëjmë me pjesën tjetër që ka të bëjë me performancën e administratës, burimet njerëzore, prioritetet e Këshillit dhe në fund kemi situatën e sistemit të drejtësisë.

Nga ana juaj është përcjellë raporti. Janë reflektuar edhe sugjerimet që kanë pas anëtarët në pjesën e përmbajtjes së raportit. Kështu që unë shkurtimisht po kaloj në pjesën e relacionit.

Siç e thashë, projektraporti përbëhet nga 10 kapituj duke pasqyruar veprimtarinë dhe rezultatet e Këshillit dhe sistemin gjyqësor në disa dimensione të shprehura përmes shifrave, analizës së plotë narrative, po edhe pjesëve të dedikuara të gjetjeve më të rëndësishme. Në terma të përgjithshëm, çështjet e trajtuara në këtë raport janë: - Veprimtaria e vetë institucionit, e cila shpërfaqet përmes funksionimit të komisioneve të përhershme dhe të përkohshme, të materializuara në vendimmarrjet respektive, e që janë themelore për të gjithë veprimtarinë e Këshillit;

- më pas kemi nivelin e zbatimit të Rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe BE-së për vitin 2023, pra Kuvendi vit për vit për Këshillin ka miratim rezolute që për ne duhet të jetë busull orientuese për atë që ne duhet të plotësojmë, e cila shpreh qëndrimin proaktiv të Këshillit për të adresuar përmes mjeteve ligjore, institucionale dhe administrative [...];

- pjesa tjetër është organizimi i brendshëm, i cili hedh dritë mbi kapitalin njerëzor të Këshillit dhe sistemit gjyqësor, me fokus kryesor ngritjen e kapaciteteve profesionale si dhe zhvillimin e tyre të mëtejshëm; pjesa tjetër ka të bëjë me veprimtarinë buxhetore dhe financiare, e cila ofron një analizë transparente dhe të thelluar mbi burimet financiare sipas zërave;

- më pas kemi digjitalizimin i cili është një prioritet ambicioz i Këshillit për sistemin gjyqësor, fokusohet në ridizenjimin dhe optimizimin e proceseve të punës, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe shpejtësisë në trajtimin e çështjeve ligjore;

- kapitulli tjetër ka të bëjë me hartën e re gjyqësore e cila evidenton të gjithë procesin e riorganizimit të kompetencave tokësore të gjykatave duke rishpërndarë të gjitha burimet njerëzore të disponueshme, si magjistratët (gjyqtarë) ashtu dhe punonjësit e administratës gjyqësore, proces ky i cili u realizua në një kohë rekord dhe me efekte financiare minimale. Vlen për të theksuar që me gjithë ristrukturimin që KLGJ ka bërë, ajo që është për t'u vlerësuar, të paktën nga grupi i punës dhe grupi i ristrukturimit është që neve nuk kemi asnjë humbje të kapaciteteve njerëzore në gjykata dhe kjo në fakt është diçka për t'u përgëzuar sepse mënyra se si kanë vepruar grupet e ristrukturimit dhe gjykatat, kanë bërë që të akomodohen të gjithë burimet njerëzore dhe ne nuk kemi asnjë humbje në burimet njerëzore. Gjithashtu në këtë kapitull del në pah veprimtaria e grupit të punës "Për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata", e cila është një masë tjetër që ka marrë Këshilli me qëllim rritjen e efijencës në sistemin gjyqësor;

- kemi analizën e situatës në gjykata, ofron një tablo me informacion të thelluar sasior dhe cilësor mbi nivelin e efijencës dhe cilësisë së drejtësisë që jepet në gjykatat e vendit, tashmë të riorganizuara. Por duhet të theksojmë që ky vit është një vit tranzitor, është një vit tranzitor për shkak të zbatimit të hartës gjyqësore, dhe nuk mund të bëjmë një nivel krahasimor siç kemi bërë në vitet e tjera, pra nuk është viti tipik që ne mund të shohim rezultatet e zbatimit të hartës së re gjyqësore, e thënë kjo jo vetëm nga ekspertët e huaj por e thënë kjo edhe nga ekspertët tanë;

- bashkëpunimi ndërinstytucional dhe ndërkombëtar, e cila është një qasje e

Këshillit, sa institucionale aq dhe proaktive me një larmishmëri institucionesh, si shtetërore, grupe interesi, partnerë ndërkombëtarë, bashkëpunime në kuadër të procesit të negociatave që kemi për integrimin;

- e fundit por jo më pak e rëndësishme ka të bëjë me transparencën dhe marrëdhëniet me publikun, e cila dëshmon për angazhimin maksimal të Këshillit për të komunikuar në mënyrë profesionale, të hapur dhe cilësore me publikun dhe median.

Unë dëshiroj të ndalem vetëm në pjesën se çfarë kemi arritur të bëjmë për gjithë këtë vit dhe në fakt vlerësoj shumë punën e bërë nga të gjithë kolegët sepse ka qenë një vit shumë ambicioz dhe po të shohim në shifra, me të vërtetë është punuar shumë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Kemi zhvilluar gjithsej 80 mbledhje plenare dhe kemi miratuar gjithsej 743 vendime (24% më shumë se 1 vit më parë) nga të cilat 27 akte nënligjore, 506 akte individuale, 162 akte kolektive, 47 akte rregulla të brendshme dhe 1 udhëzim.

Kemi zbatuar me sukses zbatimin e Hartës së Re Gjyqësore, përmes hartimit të një pakete të plotë prej 60 aktesh (administrative dhe individuale) që jo vetëm garantuan funksionalitetin pa ndërprerje të shërbimeve gjyqësore për publikun por maksimizuan miradministrimin e burimeve njerëzore dhe financiare.

Është bërë ngritja e grupit të punës “Për hartimin e strategjisë për uljen” e cila vjen jo vetëm si një nevojë e sistemit gjyqësor por është gjithashtu një nga parakushtet që kërkohet edhe nga BE-ja.

Plotësimi pothuajse i plotë i Gjykatës së Lartë me 19 anëtarë, pavarësisht se mbetemi akoma në pritje të një procedure zëvendësuese, por në kuptimin e funksionalitetit kjo gjykatë është tërësisht funksionale.

Vazhdimi i zbatimit të reformës për nëpunësin civil gjyqësor përmes një sërë masash duke realizuar:

- Unifikimin e standardeve të administrimit të brendshëm gjyqësor përmes miratimit të rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësisë të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë nëpër gjykata;

- Vijimin e misionit për garantimin e profesionalizimit, integritetit dhe

Ilogaridhënies së nëpunësve civilë gjyqësorë, përmes:

- përcaktimit të 15 kuotave për ndihmës ligjorë për vitin akademik 2023-2024;
- zhvillimit dhe përfundimit të procedurave për verifikimin e 7 kancelarëve në detyrë;
- verifikimit dhe pranimit në shërbimin civil gjyqësor për 4 nëpunës civilë gjyqësorë, 3 ndihmës ligjorë në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apeleve dhe 1 këshilltar ligjor pranë njësisë së shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

Përgatitja dhe rekrutimi i gjyqtarëve të rinj. Duhet të themi që Këshilli ka punuar në mënyrë mjaft efektive për emërimin e 40 magistratëve të cilët kanë përfunduar programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magistraturës për 2022.

- ka miratuar 40 kuota për kandidatët për magistrat “profili gjyqtar” për vitin akademik 2023-2024.

- ka kryer verifikimin e kriterëve dhe kushteve formalo-ligjore si dhe pasurisë dhe figurës për 46 kandidatë.

Ushtrimin e kompetencave lidhur me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve me qëllim vetëpastrimit e sistemit gjyqësor duke zhvilluar 6 procedimeve disiplinore, 4 prej të cilave u konkluduan me 4 procedime disiplinore pezullim deri në pritje të përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar; 2 procedurat e mbartura nga vitet e mëparshme janë përmbyllur pa një vendim përfundimtar.

Me qëllim plotësimin e trupave gjyqësore në gjykata, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka:

- Trajtuar 169 kërkesa duke caktuar 208 gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme ku ato kanë nevojë.

- Përfshirë në skemë delegimi 5 gjyqtarë dhe ka transferuar 33 gjyqtarë.

- Vazhdimi i vlerësimeve etiko-profesionale të gjyqtarëve në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, duke hartuar dhe miratuar rreth 57 raporte vlerësimi. Në periudhën 4-vjeçare 2020-2023, janë miratuar në total 156 raporte vlerësimi për 92 gjyqtarë duke vlerësuar rreth 37% të gjyqtarëve që ndodhen efektivisht në detyrë.

Vijimi i angazhimit në funksion të rritjes së transparencës dhe efijencës për

përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm të sistemeve të teknologjisë së informacionit. Pa diskutim që edhe kjo ka qenë prioritet i Këshillit.

- Mundësimi i zhvillimeve të reja si dhe trajtimi i rreth 1027 kërkesave për mbështetje teknike;

- Përfundimi me sukses i migrimit të të gjithë bazës së të dhënave nga gjykatat që ndërprejnë veprimtarinë, për shkak të riorganizimit, në gjykatat pritëse;

- Përfundimi i digjitalizimit të arkivës për 8 gjykata;

- Anonimizimi automatik i të dhënave sensitive në vendimet gjyqësore, duke ekuilibruar nga njëra anë nevojën e shtuar për transparencë dhe akses në gjyqësor dhe nga ana tjetër mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Funksionalizimi i Qendrës së Teknologjisë së Informacionit, përmes plotësimit të organikës së saj dhe hartimit të dokumenteve kornizë për ndërtimin e sistemit të ri të integruar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore për të gjithë sistemin e drejtësisë.

Vazhdimin e përpjekjeve për rritjen e transparencës, aksesit dhe besimit të publikut mbi veprimtarinë gjyqësore duke standardizuar marrëdhëniet e gjykatave me publikun dhe median përmes miratimit të udhëzuesit standard si dhe rritjes së numrit të gjyqtarëve të medias nga 8 në 17 të tillë, që mbulojnë juridiksionin e përgjithshëm dhe të posaçëm për të dyja nivelet.

Rritja e kapaciteteve profesionale për gjyqtarët dhe stafin administrativ, në kuadër të së cilës, janë trajnuar rreth 209 gjyqtarë që ushtrojnë efektivisht detyrën, 103 nëpunës civilë gjyqësorë dhe 15 punonjës të KLGJ-së, falë bashkëpunimit të ngushtë me Shkollën e Magjistraturës, projektet e asistencës së huaj, dhe Shkollën e Administratës Publike.

Le të kthehemi tek analiza e sistemit dhe gjetjet kryesore.

Si çdo vit, analiza e gjendjes së gjyqësorit, është bërë e kategorizuar sipas juridiksionit dhe nivelit të gjykatave, në përputhje të plotë me Udhëzimin që kemi miratuar me vendimin nr. 47/2021.

- Gjatë vitit 2023, sistemi gjyqësor është përballur me një ulje të lehtë të ngarkesës së punës, ku numri total i çështjeve në shqyrtim është 5.1 % më i vogël se në vitin 2022. Një ndër faktorët kontribuues në këtë drejtim është ulja e numrit të çështjeve

të reja të regjistruara.

- Gjatë vitit 2023, qytetarët i janë drejtuar më pak gjykatave duke sjellë një ulje prej 9.5 % të çështjeve të reja të regjistruara, krahasuar me vitin paraardhës.

- Pjesa më e madhe e gjykatave kanë funksionuar me kapacitet të reduktuar të gjyqtarëve, nën 70 % të strukturave, ndërsa në nivel kombëtar duhet ta pranojmë që jemi akoma në 60 % të organikës së gjykatave, duke qenë se kanë qenë efektivisht, pra kjo ka qenë organika efektivisht në detyrë gjatë vitit 2023.

- Ngarkesa e punës në gjykata është përballuar nga vetëm 247 gjyqtarë ose 8.94 gjyqtarë për 100.000 banorë (krahasime që bëhen me standardet e CEPEJ). Ky raport është 60% më pak se e normës evropiane (e cila orienton që të kemi 22.2 gjyqtarë për 100.000 banorë).

- Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar në rang vendi, gjatë vitit 2023, ka qenë pothuajse 566 çështje për gjyqtar, që shënon një rritje me 5 çështje më tepër krahasuar me vitin e mëparshëm.

- Gjykatat kanë bërë përpjekje për të ruajtur ritmin e zgjidhjes së çështjeve, mesatarja e normës së likuidimit të çështjeve në rang vendi paraqitet e ndryshme.

- Gjykata e Lartë vijon trendin rritës të normës së likuidimit të çështjeve civile dhe administrative dhe ka arritur të kalojë pragun me 100% për të tria kategoritë, duke shqyrtuar 3.7 herë më shumë çështje sesa regjistrimet e reja.

- Norma e likuidimit të çështjeve për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm nuk paraqitet në nivelet që do donim. Vërehet se në krahasim me vitin e mëparshëm ka ulje të likuidimit të çështjeve. Nga të dhënat rezulton se, norma e likuidimit të çështjeve civile është ulur me 38% dhe e çështjeve penale me 12.1%. Por kjo ka të bëjë me faktin sikurse e shpjegova, me faktin e zbatimit të hartës së re gjyqësore. Pra nuk është një vit tipik që ne mund të vlerësojmë performancën e gjykatës së apelit të përgjithshëm.

- Gjykata Administrative e Apelit ka arritur ritme më të larta të normës së likuidimit. Treguesi për këtë gjykatë për vitin 2023 është 43%. Ndonëse norma e likuidimit është rritur me 55% më shumë se një vit më parë, ajo ende vazhdon të jetë nën

100%.

- Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJPAKKO), ka arritur një normë likuidimit 103.3%.

- Për Gjykatat e Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm likuidimi i çështjeve civile për 2023 (*lapsus relativus i vitit 2003*), paraqitet në vlera të ndryshme. Në vështrim të përgjithshëm treguesi mesatar për çështje civile është ulur me 5%, ndërsa për çështjet penale është rritur me 2%.

- Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka arritur një normë likuidim të çështjeve në masën 100.9%.

- Në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit administrativ vërehet se norma e likuidimit të çështjeve është nën 100%. Tirana e ka më të lartë, me 91.25% dhe Lushnja 87.8%.

Megjithatë për shkak të kohës së shkurtër të zbatimit të hartës, këto konstatime duhet të merren me rezervë, për tu vlerësuar objektivisht gjatë viteve në vijim.

Më në detaj, treguesit e analizës më poshtë i keni edhe në mënyrë më të detajuar por unë u ndala vetëm në dy treguesit për të kuptuar krahasimisht si kemi qenë në vitet në vijim.

Gjithashtu do doja që të fokusohesha në angazhimet për KLGJ-në.

Në kuadrin e kryerjes së bilancit për vitin 2023 dhe në njohje të plotë të rolit dhe funksioneve të tij, Këshilli Lartë Gjyqësor, pa diskutim që do të vazhdojë punën e tij me përgjegjësi e përkushtim për 2024 duke marrë angazhimet si më poshtë vijon:

1. Vijimi i plotësimin të kuadrit ligjor/nënligjor të nevojshëm për të gjitha proceset dhe çështjet me fokus planifikimin strategjik, administrimin dhe buxhetin e sistemit gjyqësor, ato që lidhen me veprimtarinë dhe mirëfunksionimin e gjykatave, vlerësimin, promovimin dhe disiplinën e gjyqtarëve në të gjithë Republikën e Shqipërisë, të propozuara apo që do të propozohen nga grupi i punës “Për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata”.

2. Pa diskutim do vazhdojë zbatimi i reformës për nëpunësin civil gjyqësor përmes zbatimit të procedurave transparente dhe meritokratike të rekrutimit dhe

finalizimit të paketës së akteve të nevojshme. Në fakt në mbledhjen e sotshme disa prej akteve që plotësojnë detyrimin, i kemi të parashikuara në mbledhjen e sotshme.

3. Hartimin, miratimin dhe zbatimin në praktikë të strategjisë dhe masave ligjore e administrative në funksion të rritjes së efikasitetit.

4. Përshpejtimin e ritmit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve në përputhje me programin e përcaktuar nga KLGJ-ja si dhe emërimin dhe promovimin e tyre.

5. Vazhdojmë të kemi si angazhim thellimin e bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës për përcaktimin e kuotave.

6. Fuqizimin e përpjekjeve për të vijuar rritjen e transparencës.

7. Dhe ajo që është shumë e rëndësishme është vijimi i përpjekjeve për të siguruar fondet e nevojshme për ndërtimin jo vetëm infrastrukturor të gjykatave, fakt të cilin ne e kemi theksuar në shumë mbledhje dhe që kemi ngritur dhe vazhdojmë e artikulojmë përpara Kuvendit, por edhe të ndërtimit të një sistemi të integruar të menaxhimit të çështjeve, sistem i cili nga ana e KLGJ-së dhe e Bordit janë përmyllur të gjithë projekt-aktet e nevojshme që duhen për ngritjen e një sistemi të ri.

Nga Kuvendi, ajo që ne kemi kërkuar dhe që vazhdojmë e kërkojmë është:

- Miratimin e ndryshimeve ligjore, nga ku kemi dy paketa ndryshimesh ligjore. Paketa e parë ka të bëjë që në vitin 2022 për të cilën ne kemi bërë edhe një seancë dëgjimore me Kuvendin dhe që jemi në pritje; dhe Kuvendi vazhdon thotë që do e kemi në kalendar. E dyta është disa ndryshime ligjore që ka propozuar grupi i punës “Për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve...” si pjesë e paketës për strategjinë, pasi marrja e masave për strategjinë, për uljen e numrit të çështjeve nuk është vetëm nga ana e Këshillit, por mendoj që është një çështje kombëtare dhe që duhet të jenë proaktivë jo vetëm sistemi gjyqësor por duhet të jetë proaktiv edhe Kuvendi edhe Ministria (edhe Qeveria), për të plotësuar nevojat që ka sistemi, në mënyrë që të targetojmë atë objektiv që ne kemi.

- Një nga nevojat është mbështetja financiare për zbatim të Hartës së Re Gjyqësore. Për ato kolegë që nuk kanë qenë, nga ana e Këshillit është bërë në mënyrë të

përhershme artikulimi i nevojave, takimeve që i kemi bërë, por deri tani, ajo që konstatojmë është që pavarësisht se këto nevoja janë bërë përpara 4-5 vjetëve dhe përpara procesit të hartës, aktualisht jemi akoma në fazën që Kuvendi dhe Qeveria nuk na i kanë plotësuar.

- E fundit është mbështetja financiare për ndërtimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Kjo ishte shkurtimisht. Raporti është shumë i detajuar. Në fakt falënderoj grupin e punës që ka bërë të mundur hartimin e raportit dhe të gjithë stafin e KLGJ-së, komisionet, anëtarët, që kemi adresuar të gjithë çështjet që ne i kemi prioritare.

Ndonjë diskutim?

Alban Toro: Thjesht, sepse, vazhdimisht flasim për qëndrimet refraktare të Ministrisë së Financës dhe aktorëve të tjerë të cilët janë të detyruar të suportojnë pushtetin gjyqësor në modernizimin e gjykatave dhe vazhdimisht vazhdojmë të jemi në udhëkryq në lidhje me përmirësimin e kësaj infrastrukture, kështu që unë kam sugjeruar kur bëra disa vërejtje në lidhje me raportin që të shoqërohej edhe me pamje vizuale të zyrave ku zhvillohen gjykimet sepse aktualisht, nuk e di nëse në Parlament ka vajtur apo e kanë idenë që shumë gjykime në shkallë të parë bëhen nëpër zyra gjyqtarësh, të cilët nuk sigurojnë asnjë lloj transparence për publikun, se s'po flasim pastaj për kushte komode për gjyqtarin apo për ata që ndjekin gjykimet. Nuk mund të bëhet fjalë për gjykime online. Është një terminologji që duket sikur vjen nga një shoqëri e huaj. Sepse po luftojmë për kushtet minimaliste.

Kështu që, për të mos e zgjatur shumë. Unë do dëshiroja, nëse janë dakord edhe të tjerët, që të shoqërohen me pamje vizuale të një dite gjyqësore në shkallën e parë, të ambienteve të këtyre gjykatave, të ambienteve të gjykatës së apelit Tiranë, të ambienteve të Gjykatës së Lartë, e cila po ashtu ka mungesa të theksuara për kushte pune. Dhe nuk ka asgjë të keqe në këtë pjesë sepse ndoshta pjesa vizuale do t'i ngacmojë më shumë parlamentarët tanë të nderuar, që të reagojnë ndaj qëndrimeve refraktare që shumë aktorë të cilët do të suportonin dhe kanë për detyrim të suportojnë dhe jo të bllokojnë fondet, të

ndihmojnë për ta zgjidhur këtë situatë, qoftë edhe duke kaluar buxhetin thjesht në ndryshimet ligjore, të kalojnë buxhetin thjesht në miratimin dhe intelektualori i vetëm për buxhetin të jetë vetëm Parlamenti dhe askush tjetër.

Naureda Llagami: Në kuptimin vizual? Foto? Të bëjmë 2-3 foto, CD.

Unë mendoj më mirë CD, se foto e kemi të pamundur për shkak të kësaj, por një CD dhe t'ia bashkëlidhim raportit kur ia çojmë Kuvendit. Të bëjmë 2-3 filmime që të shohin situatën, gjendjen e sistemit. Boll të shohin zyrat dhe kuptohet shumë thjesht se ku punon gjyqtari. Këtë po, mund ta bëjmë, në qoftë se ju e vlerësoni.

Nëse unë do jem për të raportuar, Alban, këtë çështje do ta them dhe ndoshta do t'i printoj dhe do t'ia shpërndaj edhe Komisionit të Ligjeve aty, që t'i them: -Urdhëro si jemi me kushtet. Pra këtë gjë, nëse do jem akoma për të raportuar, këtë gjë do ta zgjidh duke printuar (bëjmë dy-tre foto) dhe t'i them: Urdhëroni! A punohet në këto lloj kushtesh që po punojnë gjyqtarët sot? Dakord?

Unë mendoj që kjo lloj ideje, në qoftë se do bëjmë atë lançimin e strategjisë, ne duhet të bëjmë një filmim të vogël dhe ta fillojmë ndoshta aktivitetin me këtë filmim, si janë kushtet në gjyqësor. Do jenë edhe ambasadorët, do jenë edhe përfaqësues të Kuvendit. Këtu e fillojmë direkt aktivitetin me në sfond kushtet e sistemit. Kurse tek Kuvendi unë mendoj të marrë dhe të bëj këto fotografi dhe po ia shpërndaj ditën që do shkoj, po ia shpërndaj të gjithë atyre deputetëve, për t'i treguar atyre në çfarë kushtesh jemi.

Do t'i deklarojmë të gjitha. Ato që kemi bërë do i themi, derisa i themi këtu, i themi dhe atje. Kështu që sugjerimi juaj mund të adresohet në këtë lloj gjëje.

Ndonjë gjë tjetër?

Nëse jo, kalojmë në miratimin e raportit?

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord. I bashkohem edhe komentit të Kryetares për falënderimin për grupin e punës, të gjithë stafin administrativ të Këshillit të Lartë Gjyqësor që me të vërtetë kanë punuar shumë dhe shifrat e tregojnë një gjë të tillë, si dhe për anëtarët të cilëve i mbaroi mandati vitin e kaluar sepse është edhe puna e tyre: znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...}.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord. I tha Keli ato që do thoja në fund unë për falënderimin e stafit, patjetër, por edhe për anëtarët që nuk janë prezent sepse puna e tregon vetë se sa kemi punuar.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.04.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për komandimin e znj. {...} si “ndihmësmagjistrate”, në Gjykatën e Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Klodian Kurushi.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:30 dhe mbaroi në orën 12:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|--------------------|------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje, zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Ilir Rusi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Rezarta Taushani, Dorina Priifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 6. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.**
- 7. Edmon Hoxhaj, Birn.**
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtim i projektvendimit “Për komandimin e znj. {...} si “ndihmësmagjistrate”, në Gjykatën e Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Klodian Kurushi.

Naureda Llagami: Shkurtimeisht kalojmë tek aktet në vijim.

Kemi të bëjmë me komandimin e znj. {...}. Zoti Kurushi relator. Jemi njohur me relacionin, kështu që shkurtimeisht.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Me relacionin jemi njohur. Është përzgjedhur kandidatja për t’u përfshirë si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë, si kandidatë e vetme. Është bërë intervistimi nga

Gjykata e Lartë e cila na ka kthyer përgjigje me shkresën zyrtare përkatëse dhe jep pëlqimin/dakordësohet për t'u përfshirë zonja {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë. Më tej relacioni vijon me përcaktimin e kohës kur duhet të fillojë komandimi në Gjykatën e Lartë. Për shkak të ngarkesës së punës që ajo ka dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Në relacionin përkatës është i përfshirë i gjithë materiali përkatës që lidhet me ngarkesën e punës si gjyqtare në gjykatë, numrin e çështjeve, fazën në të cilën ndodhen këto çështje, llojet e çështjeve, natyra e çështjes dhe duke iu referuar edhe një korrespondence që kemi mbajtur me gjyqtaren, me qëllim që largimi nga pozicioni ku ajo aktualisht ushtron funksionin si gjyqtare të mos rëndojë më tepër seç duhet mbi kolegët e tjerë, ne duke marrë mendimin e saj dhe duke bërë një vlerësim të të gjitha rrethanave të çështjes, propozojmë komandimin e gjyqtares në pozicionin e ndihmësmagjistratit në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Lartë. Afati i komandimit të jetë 5 vjet dhe ky afat të fillojë më datë 01.06.2024. Domethënë të përfshijë në funksionin e saj si magjistrate në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan veprimtarinë e saj deri në datën 1 qershor dhe më datë 1 qershor pastaj të fillojë funksionin si ndihmësmagjistrate e komanduar në Gjykatën e Lartë.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, kemi diskutime?

Nëse jo, kalojmë në votim.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga Komisioni. Dhe fillimi është me datë 1.06.2024.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.04.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 245, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Alban Toro.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:30 dhe mbaroi në orën 12:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Irena Plaku*** (anëtare)
- 5. Gentiana Muçaj*** (anëtare)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)

7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Yllka Rupa* (anëtare)
9. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje, zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Illir Rusi*.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje, z. *Markelian Koça*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
6. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.*
7. *Edmon Hoxhaj, Birn.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtim i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 245, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Alban Toro.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me verifikimin

dhe plotësimin nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit. Po!

Markelian Koça: Një ndërhyrje.

E kam prezantuar më përpara për të evituar situatën e konfliktit të interesit, nuk do të marrë pjesë në votimin e kësaj çështjeje.

Naureda Llagami: Atëherë, Ok!

Zoti Markelian nuk përfshihet në shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Atëherë, shkurtimisht z. Toro lidhur me çështjen.

Alban Toro: Në kuadër të përpjekjeve që ka bërë Këshilli i Lartë Gjyqësor për plotësimin e vakancave në sistemin gjyqësor, në mënyrë të veçantë për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në këtë kuadër, me vendimin nr. 245, 24.05.2023 është proceduar për hapjen e një pozicioni të lirë në fushën e së drejtës civile.

Një nga kandidatët për këtë pozicion është edhe zonja {...}, aktualisht gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Në lidhje me të Këshilli ka kryer disa veprime procedurale ku vlen të evidentojmë vendimin 57, 07.02.2024 për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile shpallur me vendimet nr. 239 deri në nr. 247, datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 235, 236, 237 dhe 238 datë 24.05.2023, dhe fillimi i procedurës së verifikimit të kritereve ligjore.

Në kuadër të të qenit relator për këtë kandidate, kam administruar aktet e nevojshme të cilat në përputhje me neni 8/3, 47/4, 48/8, do të mundësonin kualifikimin e kandidates.

Në këtë kuadër kam administruar dokumentacionin nga burimet njerëzore në lidhje me përvojën profesionale minimale, ku nga ky informacion rezulton se zonja {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në

datën 28.06.2003 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2012. Me dekretin nr. 7155, datë 10.11.2011 të Presidentit të Republikës caktohet të kryejë stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekretin nr. 8462, datë 23.01.2014 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat. Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, datë 15.03.2022 zgjidhet Zëvendëskryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe nga data 01.05.2023 ka ushtruar funksionin si Zv/Kryetare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat. Me vendimin nr. 518, datë 05.10.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet sipas procedurës së lëvizjes paralele pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku dhe aktualisht ushtron funksionin. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit është 12 vite. Aktualisht nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Nga të dhënat rezulton se ka mbi 7 vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë.

Në lidhje me përvojën specifike janë administruar akte të cilat provojnë përvojën specifike të gjyqtares. Në këtë kuadër janë administruar urdhrat për ndarjen e gjyqtarëve në dhoma, seksione dhe trupa gjykues për vitet 2014-2023. Nuk po i citoj të gjitha sepse janë renditur në mënyrë kronologjike në relacion duke filluar nga viti 2014-2022, ku ka kryer shumë gjykime civile; në 2023 ka gjykuar në total 343 çështje, nga të cilat 119 çështje civile, 103 kërkesa penale, 80 kërkesa civile dhe 41 çështje penale. Në 6 çështje penale dhe 5 çështje civile ka qene anëtare trupi gjykues. (Totali gjithsej 354 çështje).

Kam administruar njëkohësisht edhe urdhrin e vitit 2013 apo urdhrin e 2014 ku kandidatja është caktuar të gjykojë në disa trupa gjykues në periudha të ndryshme.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton se në vitin 2011, është caktuar të kryejë stazhin profesional (1vit), ku gjatë këtij stazhi gjyqtarja ka gjykuar të gjitha çështjet, si civile, administrative familjare dhe penale. Me vendimin nr. 518, 05.10.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Këshilli i Gjykatës ka vendosur që gjyqtarja të

gjykojë në seksionin civil/tregtar sipas urdhrave nr. 263, 16.10.2023 dhe vendimit nr.97, 27.03.2024. Për periudhën 05.10.2023 deri 19.04.2024 ka gjykuar në total 416 çështje.

Pra edhe në këtë aspekt gjyqtarja plotëson kriteret ligjore, atë të 5 vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile.

Nuk rezulton të ketë masa disiplinore.

Nuk rezulton të ketë papajtueshmëri ambientale, kritere të cilat do të pengonin konkurrimin e mëtejshëm të saj. Kështu që në këtë kuadër ju kam propozuar projektvendimin në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1.Verifikimin e plotësisimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr.245, datë 24.05.2023, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2.Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr.245, datë 24.05.2023.

3.Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Kemi diskutime?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit?

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga relatori.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.04.2024)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:

4.1 Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 77, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

4.2 Për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë".

Relator z. Klodian Kurushi.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:30 dhe mbaroi në orën 12:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)

5. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)
10. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje, zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Illir Rusi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
6. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.*
7. *Edmon Hoxhaj, Birn.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtim i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:
 - 4.1 Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 77, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
 - 4.2 Për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë".

Relator z. Klodian Kurushi.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me renditjen në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe më pas transferimi për z. {...}.

Klodian Kurushi: Atëherë, në mënyrë të përmbledhur po prezantoj relacionin që ka të integruar edhe dy projektvendimet tona përkatëse.

Unë po e prezantoj në mënyrë të përmbledhur për shkak se pjesa e parë e relacionit është e njohur nga kolegët si rezultat i verifikimit të tre kritereve ligjore që ne kemi bërë për kandidatin z. Stroka i cili është kualifikuar në këto tre kritere.

Më pas për z. Stroka është bërë vlerësimi etik dhe profesional dhe sipas vendimit të Këshillit nr. 173, datë 03.04.2024, kandidati është vlerësuar për periudhën 2017-2019, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 393 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit”. Sipas vendimit të Këshillit nr. 174, datë 03.04.2024, kandidati është vlerësuar për vitin 2022, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 395 pikë.

Dy vlerësimet etike dhe profesionale të kandidatit të miratuara me vendimet e Këshillit, u konstatuan të jenë bërë përfundimtarë, për të vijuar më tej procedurat e lëvizjes paralele.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në kushtet kur në këtë procedurë lëvizje paralele ka kandiduar vetëm një kandidat dhe për rrjedhojë, edhe në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve është vetëm një i tillë, u vlerësua se nuk ka vend për ndjekjen e hapave, kritereve dhe përparësive sipas përcaktimeve të Kreut VI, Seksioni B të vendimit 320/2020. Nga ana tjetër, në respektim të përcaktimeve të Seksionit D, Kreu VI, të vendimit 320/2020, relatori përgatiti projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele që i referohet pozicionit të lirë të shpallur me vendimin nr. 77/2024.

Projektvendimi në këtë rast është i strukturuar në 3 pika dhe është bashkëlidhur

këtij relacioni.

Së bashku me këtë projektvendim, duke qenë se është një kandidat i vetëm Komisioni propozon Këshillit, në zbatim të pikës 111 të vendimit të Këshillit nr.320/2020, projektvendimin për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 77/2024.

Për të përcaktuar afatin e transferimit nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele u mor informacion lidhur me ngarkesën e z. Stroka në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Sipas këtij informacioni ai ka në fazën e bisedimeve përfundimtare 6 (gjashtë) çështje; gjithashtu ka në gjykim, çështje që i janë ngarkuar me vendim të Këshillit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si edhe në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë. Në projektvendim përcaktohen edhe efektet juridike se kur duhet të fillojë afati i transferimit. Ne e kemi lënë alternativisht për ta diskutuar bashkërisht. Unë mendoj datën 1 maj, nëse kolegët bien dakord si datë e propozuar nga ana jonë për të filluar efektet juridike të vendimit të transferimit.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim paraprak?

Klodian Kurushi: Po i kemi llogaritur të gjitha.

Gjashtë janë në konkluzione përfundimtare, pjesa tjetër është në fazën e gjykimit. Ne kemi thënë ato që janë në konkluzionet përfundimtare të përfundohen prej tij dhe ato çështje për të cilat ai është caktuar si gjyqtar në gjykata të tjera... i kemi llogaritur edhe pjesën e ngarkesës: 6 çështje i ka në konkluzione përfundimtare dhe ai duhet t'i përfundojë këto të gjashta. Pjesën tjetër të çështjeve i ka në fazën e gjykimit. Ndërsa për një kategori çështjesh për të cilat ai është caktuar me vendim të Këshillit në gjykata të tjera, siç është në Gjykatën kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në Gjykatën e

Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, ai do t'i përfundojë deri në fund fare, pavarësisht faktit nëse i përfundon përpara transferimit ose pas transferimit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, në qoftë se nuk kemi diskutime, kalojmë projekt-aktin e parë që ka të bëjë me miratimin e renditjes.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli e miraton renditjen e kandidatit në këtë procedurë të lëvizjes paralele, ku në pozicionin e parë është {...}.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e dytë që ka të bëjë me transferimin e gjyqtarit në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 1.05.2024. Jemi dakord?

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet edhe ky projekt-akt.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.04.2024)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:

5.1 Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 249, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5.2 Për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

5.3 Për përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim, për gjyqtarin z. {...}".

Relator z. Markelian Koça.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:30 dhe mbaroi në orën 12:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. Naureda Llagami

(kryetare)

30

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 25.04.2024 (Pika 5)***

- | | |
|---------------------------|------------------|
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 6. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 9. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 10. <i>Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje, zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Illir Rusi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Rezarta Taushani, Dorina Priifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
6. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.*
7. *Edmon Hoxhaj, Birn.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtim i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:
- 5.1 Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të

drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 249, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5.2 Për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

5.3 Për përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim, për gjyqtarin z. {...}".

Relator z. Markelian Koça.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës i cili ka të bëjë edhe ky me miratimin e renditjes për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për z. {...}, pastaj transferimin e tij në këtë gjykatë përmes lëvizjes paralele dhe akti i tretë është përfundimi i transferimit të përkohshëm me pëlqim për këtë gjyqtar. Të tria këto akte do relatohen nga z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit zonja Kryetare!

Të nderuar anëtarë, atëherë po kaloj direkt tek relacioni meqenëse u cituan projekt-aktet nga Kryetarja.

Rezulton që me disa vendime të datës 24.05.2024 (*viti është gabim material, duhet 2023*), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka hapur procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 249, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Afati i kandidimit ka qenë 14.06.2023 (ka një gabim material tek viti në relacion).

Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me këtë vendim, ka kandiduar z. {...}, me detyrë aktualisht i transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me pëlqimin e tij.

Këshilli me vendimin nr. 346 ka miratuar listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime/ 1 vlerësim/ pa vlerësim, për efekt të këtij kandidimi.

Në vijim, me vendimin nr. 385, datë 17.07.2023 është vendosur: "I. Fillimi i

procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore për kandidimin për këtë vend edhe për kandidatin z. {...} me relator z. Alban Toro.

Sipas pikës 7, të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në një procedurë lëvizje paralele për një pozicion të lirë, Këshilli i Lartë Gjyqësor bën renditjen e kandidatëve që përmbushin kriteret, renditje kjo që bëhet në funksion të përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart.

Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit, të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në rastin konkret, janë realizuar procedurat e verifikimit të plotësimit të kushteve formale në lidhje me: “përvojës profesionale minimale”, “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Për kandidatin e vetëm, z. {...}, në përfundim të fazës së parë të lëvizjes paralele në përputhje me parashikimet e Kreut V të vendimit 320/2020 Këshilli ka verifikuar plotësimin e kriterëve dhe me vendimin nr. 463, 25.07.2023, ka vendosur kualifikimin e tij dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 249/2023.

Siç u parashtua, krahas procedurave të verifikimit të kriterëve të kandidimit, paralelisht, për kandidatin kanë vijuar edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional.

Me kualifikimin e kandidatit z. {...}, bazuar në pikën 75 vendimit të Këshillit nr. 320, datë 19.02.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, Këshilli, me vendimin nr. 205, datë 17.04.2024, ka vendosur fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan edhe për pozicionin nr. 249/2023 dhe jam caktuar unë si relator i çështjes.

Është njoftuar sipas përcaktimeve ligjore, nënligjore kandidati në lidhje me fillimin e procedurës dhe relatorit dhe nuk ka parashtuar kundërshtime.

Është bërë administrimi i dokumentacionit përkatës për kandidatin e kualifikuar që gjendet në dosjet e tij personale apo në praktikën dokumentare të procedurave të

verifikimit. Ka rezultuar në lidhje me vlerësimin se me vendimin nr. 183 datë 09.04.2024, kandidati është vlerësuar për periudhën 2020-2022, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 391 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional” të miratuar me këtë vendim; Sipas certifikatës së vlerësimit të Shkollës së Magjistraturës kandidati është vlerësuar për periudhën tetor 2015 - qershor 2018, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”.

Vlerësimi etik dhe profesional i kandidatit z. {...} i miratuar me vendimin e Këshillit nr. 183 datë 09.04.2024, konstatohet të jetë bërë përfundimtar, për shkak se ndaj tij nuk është paraqitur ankim referuar deklaratës së kandidatit të dërguar në rrugë elektronike, në datën 18.04.2024.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në kushtet kur në këtë procedurë lëvizje paralele ka kandiduar vetëm një kandidat dhe, për rrjedhojë, edhe në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve është vetëm një është vlerësuar se nuk ka vend për ndjekjen e hapave, kritereve dhe përparësive sipas përcaktimeve të Kreut VI, Seksioni C të vendimit 320/2020, në funksion të renditjes së kandidatëve.

Është paraqitur në funksion të këtyre akteve projektvendimi “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 249/2023, duke u renditur z. {...} si kandidat i vetëm.

Projektvendimi i parë është i strukturuar në 3 pika.

Sipas pikës 1 të projektvendimit, Këshillit i propozohet të miratojë renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin 249/2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: kandidati i vetëm 1) Z. {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit, përcaktohet se një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016.

Në projektvendim përcaktohet se ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në vijim, së bashku me këtë projektvendim, duke qenë se është kandidat i vetëm siç kemi proceduar edhe në raste të tjera nga Këshilli, Komisioni propozon në zbatim të pikës 111, të Vendimit të Këshillit nr.320/2020, projektvendimin për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 249/2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Projektvendimi është i strukturuar në 3 pika.

Pika 1 e projektvendimit bën fjalë për transferimin e gjyqtarit në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 249/2023.

Pika e dytë përcakton efektet juridike me një datë që mund ta diskutojmë, por në kushtet që zotëria/magjistrati aktualisht është në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, nuk ka nevojë për t'u shprehur as për çështje që duhet të gjykojë të mbarojë pra para afatit, pra do të vijojë me të njëjtën ngarkesë pune që ka aktualisht. Mund të shprehem edhe menjëherë ose me 1 maj meqenëse është data afër, si ta vlerësoj Këshilli.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet magjistratit dhe parashikohet hyrja në fuqi me votimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në kushtet kur Këshilli me vendimin nr. 529, datë 11.10.2023, ka vendosur ndër të tjera: Transferimin e përkohshëm me pëlqim të gjyqtarit z. {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një periudhë deri në një vit që mund të ndërpritet në rast të rrethanave të kushtëzuara, është vendi që Këshilli të vendosë ndërprerjen e transferimit sipas vendimit të mësipërm. Edhe për këtë vendim kemi strukturimin me tre pika.

Në pikën e parë parashikohet përfundimi para afatit i transferimit të përkohshëm me pëlqim, për gjyqtarin z. {...}.

Në pikën e dytë fillimin e efekteve të punës së tij që mund ta themi menjëherë,

nëse e vlerësojmë.

Dhe në pikën e tretë një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të ligjit, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim paraprak?

Atëherë, kalojmë në hedhjen në votim të projekt-aktit të parë që ka të bëjë me miratimin e renditjes për z. {...} i cili renditet i pari në procedurën e lëvizjes paralele të shpallur me vendimin nr. 249/2023.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë miratohet projekt-akti i cili renditet i pari z. {...}.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i dytë për të cilin nga ana e relatorit kemi një propozim.

Markelian Koça: Përpara se ta kalojmë në votim, unë propozoj meqenëse duhet të shprehemi me data, që transferimi i përkohshëm me pëlqim të mbyllet në datën 30 prill dhe fillimi i punës me lëvizjen paralele të jetë data 1 maj.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë kalojmë transferimin e gjyqtarit {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë, Juridiksioni i Përgjithshëm Elbasan, me efektet juridike që fillojnë më datë 1 maj, 01.05. Jemi dakord?

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet transferimi në procedurën e lëvizjes paralele të z. {...}, me efektet 1 maj 2024.

Naureda Llagami: Kalojmë në aktin tjetër që është përfundimi para afatit të transferimit të përkohshëm dhe efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 30 prill 2024.

Jemi dakord?

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.04.2024)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Alban Toro.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:30 dhe mbaroi në orën 12:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Klodian Kurushi* (anëtar)
3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Irena Plaku* (anëtare)
5. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Markelian Koça* (anëtar)

9. Yllka Rupa (anëtare)

10. Emona Muçi (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje, zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Illir Rusi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

4. Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.

6. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.

7. Edmon Hoxhaj, Birn.

8. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Alban Toro.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit për gjyqtaren {...}. Për më shumë detaje fjalën ia jap relatorit z. Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Atëherë, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me datën 16.04.2024 është depozituar

një kërkesë me shkresë protokolluar me nr. {...} prot., të gjyqtares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, znj. {...}, të cilën për hir të transparencës jam i detyruar ta pasqyroj ashtu siç e ka paraqitur zonja {...}, një qëndrim kontestator ndaj qëndrimit të Këshillit, i cili në përgjithësi ka shprehur një vullnet pozitiv për çdo kërkesë që ka paraqitur kjo magjistrate e cila kryesisht ka kryer një funksion jo gjyqësor dhe jashtë ambienteve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Kërkesa, siç thotë ajo: “Pasi u njoha me arsyetimin e vendimit të sipërcituar, konstatova se Këshilli ka refuzuar kërkesën për lejen e papaguar për këtë shkak. Kërkesa është paraqitur për ndjekjen e studimeve Juris Doctor për avokatinë. Përfundimi i studimeve të filluara tashmë në fushën e avokatisë vlerësohet se ka mospërputhje me funksionin e gjyqtarit dhe bie ndesh me kërkesat kryesore të funksionit.

Pa i hyrë në detaje arsyetimit të përciptë të bërë nga ana e Këshillit, lidhur me objektin e kërkesës dua të parashtroj qëndrimin tim me vijueshmërinë e detyrës si gjyqtare.

Së pari, Këshilli është vënë në dijeni lidhur me synimin për vijimin e studimeve dhe kjo kërkesë gjen pasqyrim edhe në vendimin nr. 296, datë 30.05.2023, e cila nuk është trajtuar nga Këshilli. E ndodhur në kushtet kur Këshilli nuk u shpreh për këtë kërkesë, unë vijova studimet kualifikuese.

Së dyti, dua të nënvizoj faktin se studimet e filluara prej meje janë studime për t’u bërë jurist dhe jo për t’u bërë avokat. Këto studime janë filluar me synimin e vetëm për të thelluar aftësitë profesionale në sistemin common law, që është një nga sistemet e së drejtës më të përparuara në botë dhe për t’i vënë ato në përdorim gjatë ushtrimit të detyrës. Me keqardhje konstatoj se interpretimi i letrës së pranimit “se ju po merrni vendimin për t’u bërë avokat” nuk është i bazuar. Kryerja e studimeve Juris Doctor nga një shkollë e akredituar është vetëm një nga kriteret për t’u bërë avokat. Çdo student i diplomuar duhet me patjetër të kryejë testin e etikës profesionale, testin e përshtatshmërisë në detyrë (i ngjashëm me procesin Vetting) dhe Bar Exam (provimi i avokatisë). Për të kaluar këto hapa do të duhej të qëndroja minimalisht dhe një vit tjetër nga data e përfundimit të studimeve në shtetin e {...}. Në kërkesën time shprehimisht

kam kërkuar leje deri në datën 30.09.2024. Një student normalisht i duhen tre vite kohë për të përfunduar këtë program studimi, të cilin unë e kam kryer me procedurë të përsheptuar me qëllimin e vetëm për të mos penguar kryerjen e detyrës si gjyqtare.

Së treti, e ndodhur para faktit që me vendimin nr.172 datë 03.04.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur refuzimi i lejes së papaguar për qëllime kualifikimi për një periudhë 6-mujore, unë magjistrate {...} jam e detyruar të bëj këtë kërkesë për dorëheqje nga Statusi i Magjistratit dhe nga detyra si gjyqtare pranë Gjykatës Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Kjo kërkesë për dorëheqje është e detyruar dhe jo me vullnetin tim të lirë pasi kualifikimi im studimor nuk mund të ndërpritet në fazën ku ndodhem aktualisht kur kanë mbetur më pak se 6 muaj nga përfundimi i tyre.

Duke qenë gjithmonë e përgjegjshme përpara ligjit dhe transparente për vazhdimin e studimeve për të cilat kam investuar kohë dhe vlerë të konsiderueshme monetare, ju vë në dijeni që nuk mund të ndërpres programin e studimeve.

Për sa më sipër, në kushtet kur vendimi nr. 172, datë 03.04.2024 ka hyrë në fuqi menjëherë dhe unë jam e pamundur të paraqitem në detyrë për shkak të rrethanave ku ndodhem, vlerësoj të paraqes dorëheqjen nga statusi i magjistratit...” etj., etj.

Në retrospektivë, gjyqtarja znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datën 12.07.2010, ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2013 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020. Me vendimin nr. 477, datë 20.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtare. Me vendimin nr. 506, datë 27.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Me vendimin nr. 208, datë 20.05.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor miratohet kërkesa për dhënie leje të papaguar për arsye familjare, për një periudhë 1 (një) vjeçare, deri në datë 01.06.2022. Me vendimin nr. 200, datë 31.05.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor miratohet kërkesa për zgjatje të afatit të lejes së papaguar, për një periudhë tjetër 1 (një) vjeçare, deri në datë 31.05.2023. Me vendimin nr. 131, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”, nga data 01.05.2023 qëndron në pozicion të përhershëm si gjyqtare pranë Gjykatës së

Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Me vendimin nr. 296, datë 30.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor miratohet kërkesa për dhënie leje të papaguar, për një periudhë nga data 01.06.2023 deri në datë 12.03.2024.

Vjetërsia në funksionin e magjistratit është 3 vite e 6 muaj, ku kontributi më i madh i magjistrates znj. {...} dhe konkretisht periudha prej 2 vite, 9 muaj e 11 ditë ka qenë ajo e lejes të papaguar të miratuar, me motiv krijim i familjes apo përkujdesje për të, të përfituar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndërkohë për periudhën prej 8 muaj e 17 ditë ka ushtruar funksionin efektivisht si gjyqtare.

Nga aktet rezulton se nga data 12.03.2024, datë në të cilën do të duhej të ishte integruar në trupën gjyqësorë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, nuk është paraqitur dhe nuk rezulton të ketë depozituar akte të cilat do të justifikonin mungesën e saj, detyrim i përgjegjësisë ligjore statuore. Si garantues i drejtësisë, vlerë themelore në një shtet të qeverisur nga shteti i së drejtës, gjyqësori duhet të gëzojë besimin publik në qoftë se ai fillimisht duhet të ketë sukses në përmbushjen e detyrimeve individuale dhe respektimin me rigorozitet të legjislacionit në fuqi në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Përfundimi i lejes së papaguar dhe kthimi në detyrë do të konfirmonte përgjeshmërinë për ti bërë ballë ndikimit negativ të stereotipizimit të vijueshmërisë së lejes duke mos kompromentuar në këtë mënyrë besimin jo vetëm të Këshillit por edhe të publikut në detyrimin për të garantuar kriteret e respektimit të ligjit, kompetencës, të qenit të hapur dhe të paanshëm edhe në trajtimin e aspekteve familjare individuale në raport me detyrimin e ruajtjes së interesit publik, që janë të ngërthyera në detyrën gjyqësore dhe për të cilën shoqëria ka pritshmërinë e kthimit të investimit të saj në burimet gjyqësore të gjykatës.

Në kërkesën e saj, datë 16.04.2024, gjyqtarja ka kërkuar mbarimin e mandatit, mbarim i cili mbështetet në nenin 65 të ligjit nr. 96/2016. Nuk po e citoj dispozitën.

Në këto kushte, kur për dorëheqjen respektohet vullneti dhe është akt vullnetar i njëanshëm i gjyqtarit, jam i detyruar të përpiloj këtë draft. Ka edhe vendime të Gjykatës Kushtetuese të cilat sanksionojnë vullnetin e gjyqtarit në këtë prizëm. Kështu që në këto

kushte jam i detyruar të relatoj dhe t'ju paraqes për miratim projekt-aktin në dispozitivin e të cilit ju sugjeroj të miratoni:

Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për shkak të dorëheqjes së saj.

Në pikën dy kam bërë një ndryshim të vogël pasi fillimisht kam propozuar datën 16.05.2024 si datë për të cilin ky urdhërim do të kishte efektet e veta, ndërkohë duke respektuar edhe konsultën e bërë nga kolegët, e kam modifikuar me datën 31.05.2024, përfundim i cili nuk na pengon që ndërkohë të hapim edhe një pozicion të lirë pranë kësaj gjykate.

Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit relatorit!

Nëse nuk kemi diskutime kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit dhe relacionit të detajuar që dha relatori.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga relatori.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.04.2024)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr.256, nr.257 dhe nr.258, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Markelian Koça.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:30 dhe mbaroi në orën 12:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Gentiana Muçaj*** (anëtare)
- 5. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 6. Alban Toro*** (anëtar)
- 7. Markelian Koça*** (anëtar)

8. *Yllka Rupa* (anëtare)

9. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje, zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Illir Rusi*.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje znj. *Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

4. *Rezarta Taushani, Dorina Priifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

5. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*

6. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.*

7. *Edmon Hoxhaj, Birn.*

8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr.256, nr.257 dhe nr.258, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Markelian Koça.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-aktet e radhës. Kalojmë tek projekt-akti që ka të bëjë me kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës.

Zonja Irena Plaku nuk merr pjesë në këtë proces.

(Largohet nga salla e mbledhjes znj. Irena Plaku.)

Naureda Llagami: Kalojmë në relatimin e tij nga z. Markelian Koça.

Markelian Koça: Faleminderit zonja Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës i kam paraqitur mbledhjes plenare projektvendimin “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr.256, nr.257 dhe nr.258, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Në relacionin bashkëlidhur projektvendimit ju bëj me dije se me vendimet e mësipërme Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur hapjen e procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative.

Në këto procedura, afati i kandidimit ka qenë përcaktuar në dy javë dhe përfundonte në datën 14.06.2023. Brenda afatit për pozicionet e lira nr.256, nr.257 dhe nr.258, datë 24.05.2023 ka kandiduar edhe magjistratja znj. {...}, aktualisht gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

Mbas përfundimit të afatit të kandidimit në procedurën e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët, mbështetur në pikën 9 të vendimeve 256/2023, 257/2023 dhe 258/2023, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr. 346, datë 27.06.2023, Këshilli ka miratuar listën e kandidatëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim etike dhe profesionale (shtojca nr. III) për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe znj. {...}.

Me vendimin nr. 161, datë 03.04.2024, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet e cituara më lart, për

kandidatët që nuk kanë asnjë vlerësim, Këshilli ka vendosur ndër të tjera fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele edhe për zonjën {...} me relator Markelian Koça.

Më datë 03.04.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në vendimin e Këshillit nr. 320/2020, në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua: i) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; ii) për caktimin e relatorit; iii) për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

Është njoftuar rregullisht dhe nuk ka parashtruar asnjë pretendim për sa më lart.

Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 55, Seksioni C, Kreu V, të vendimit 320/2020, përmes shkresave të veçanta, për kandidaten është kërkuar dhe është administruar informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale specifike” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me anë të postës elektronike ka përcjellë informacionin dhe dokumentacionin përkatës.

Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale specifike” në fushën e të drejtës përkatëse, referuar gjykatave ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtares, informacioni nuk iu kërkua gjykatave, ndërsa është e qartë përvoja e kandidatit në fushën e të drejtës administrative në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër/Vlorë dhe Lushnjë.

Rezultatet e verifikimit për zonjën {...} rezultojnë se në lidhje me kriterin e përvojës specifike minimale - “Përvoja profesionale specifike minimale” për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, në rastin konkret në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, gjë që reflektohet në shkronjën “a”, të pikës 5, të vendimeve nr. 256, nr. 257 dhe 258 datë 24.05.2023, në parashikimet që janë të njohura dhe s’po i lexoj.

Për verifikimin e kandidates në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për lëvizjen

paralele mbahet parasysh se ajo ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimet përkatëse të cituara, çka do të thotë se kandidatja duhet të ketë të paktën një vit përvojë profesionale në fushën e së drejtës administrative gjatë pesë viteve të fundit para kandidimit.

Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidatja, evidentohet se ajo ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datën 09.07.2009, dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019. Me vendimin nr. 53, datë 29.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe më pas me vendimin e datës 19.10.2021 Këshilli ka vendosur transferimin dhe përsëritjen e transferimit të përkohshëm si gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Në vijim me vendim nr. 272, datë 25.05.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë” nga data 01.07.2023 transferohet në pozicionin e përhershëm si gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, ku dhe aktualisht ushtron detyrën e magjistratit duke gjykuar vetëm çështje me natyrë administrative.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, (i lexova, s’po i përsëris prapë nga e para). Rezulton se vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 4 vite. Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale, referuar të dhënave, rezulton se kandidatja z. {...}, nga data 29.01.2020 dhe në vijim, është gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë/Vlorë e më pas Lushnjë, e për rrjedhojë që nga kjo datë rezulton të ketë gjykuar vetëm çështje të natyrës administrative.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionet nr. 256, nr. 257 dhe 258 datë 24.05.2023, rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale

si gjyqtare në fushën e së drejtës administrative.

Është verifikuar kriteri i mospasjes masë disiplinore dhe rezulton që nuk ka masë disiplinore. Është paraqitur, administruar dhe vetëdeklarimi i datës 02.06.2023, sipas së cilës nuk ka masë disiplinore.

Edhe nga verifikimi nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit rezulton se zonja {...} nuk ka masa disiplinore.

Për kriterin e papajtueshmërisë ambientale sipas procedurës dhe njoftimeve është paraqitur edhe deklarata se nuk do të ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë ambientale nëse kandidon për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, po ashtu rezulton që nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit me lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Në këto kushte është shqyrtuar materiali nga Komisioni dhe Komisioni ka vendosur t'i përcjellë Këshillit projektvendimin sa më lart.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Nëse kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të detajuar ardhur nga relatori.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë miratohet projekt-akti.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.04.2024)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.256, nr.257 dhe nr.258, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Markelian Koça.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:30 dhe mbaroi në orën 12:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Gentiana Muçaj*** (anëtare)
- 5. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 6. Alban Toro*** (anëtar)
- 7. Markelian Koça*** (anëtar)

8. *Yllka Rupa* (anëtare)

9. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje, zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Illir Rusi*.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

4. *Rezarta Taushani, Dorina Priifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

5. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*

6. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.*

7. *Edmon Hoxhaj, Birn.*

8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.256, nr.257 dhe nr.258, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Markelian Koça.

Naureda Llagami: Atëherë kalojmë tek projekt-akti i dytë që ka të bëjë me kualifikimin e z. {...}. Shkurtime nga ana e relatorit të prezantohet ky projekt-akt.

Markelian Koça: Faleminderit zonja Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Meqenëse jemi në të njëjtat kushte si me kandidaten e mëparshme, po dal direkt në konkluzionet e arritura nga Komisioni, nëse s'keni kundërshtim, sepse pjesa formale është po ajo.

Nga rezultatet e verifikimit për z. {...} rezulton se në lidhje me përvojën profesionale specifike për lëvizjes paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, në rastin konkret në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të vendimeve nr. 256, nr. 257 dhe 258.

Për verifikimin e kandidatit në lidhje me plotësimin e këtij kriterëve të vjetërsisë për lëvizjen paralele mbahet parasysh se ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimet e cituara më lart, çka do të thotë se kandidati duhet të ketë të paktën një vit përvojë profesionale në fushën e së drejtës administrative gjatë pesë viteve të fundit para kandidimit.

Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati, evidentohet se ai ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” në datë 03.07.2006 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019. Me vendimin nr. 52, datë 29.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe më pas me vendimin e datës 07.05.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, transferohet dhe i përsëritet transferimi i përkohshëm si gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, datë 16.06.2022 zgjidhet Zëvendëskryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, funksion të cilin e ka ushtruar deri në datë 30.06.2023. Në vijim me vendimin nr. 272, datë 25.05.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë” prej datës 01.07.2023 transferohet në pozicion të përhershëm si gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë. Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të

Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, me datën 03.07.2023 zgjidhet Zëvendëskryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, funksion të cilin ushtron edhe aktualisht duke gjykuar vetëm çështje administrative.

Edhe nga informacioni dhe dokumentacioni i administruar nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative konfirmohet sa më lart. Nuk po i lexoj që t'i përsëris nga e para. Rezulton se vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 4 vite. Z. {...} nuk ka masa disiplinore.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale, referuar të dhënave, rezulton se z. {...}, nga data 29.01.2020 dhe në vijim, është gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë/Vlorë e më pas Lushnjë, e për rrjedhojë që nga kjo datë ai gjykon vetëm çështje me natyrë administrative.

Nga të dhënat e administruara rezulton që ka mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës administrative.

Është verifikuar kriteri i mospasjes masës disiplinore dhe është administruar formulari i vetëdeklarimit 07.06.2023 sipas të cilës kandidati deklaroi se nuk ka masa disiplinore në fuqi. E njëjta gjë konfirmohet edhe informacioni i përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, pra që zoti {...} nuk ka masa disiplinore.

Në lidhje me kriterin e “papajtueshmërisë ambientale” është administruar deklarimi i kandidatit nëpërmjet të cilit deklaroi se nuk është dhe nuk do të ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë ambientale në rast se do të kryhet transferimi për lëvizjen paralele.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton që nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Për këto arsye, pasi është administruar dokumentacioni i nevojshëm, u shqyrtuar në Komision dhe Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon mbledhjes plenare miratimin e projektvendimit bashkëlidhur relacionit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet sipas propozimit të relatorit.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.04.2024)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr.256, nr.257 dhe nr.258, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Alban Toro.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:30 dhe mbaroi në orën 12:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Gentiana Muçaj*** (anëtare)
- 5. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 6. Alban Toro*** (anëtar)
- 7. Markelian Koça*** (anëtar)

8. *Yllka Rupa* (anëtare)

9. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje, zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Illir Rusi*.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje znj. *Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

4. *Rezarta Taushani, Dorina Priifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

5. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*

6. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.*

7. *Edmon Hoxhaj, Birn.*

8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr.256, nr.257 dhe nr.258, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Alban Toro.

Naureda Llagami: Atëherë kalojmë tek kualifikimi i kandidatës {...}. Relator është z. Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Më herët, me vendimet nr.256 - nr.258, datë 24.05.2023 KLGJ ka vendosur hapjen e tre procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative.

Një nga kandidatet për këto pozicione është edhe zonja {...}, aktualisht gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, por e komanduar si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë.

Për këtë magjistratë janë kryer disa veprime procedurale. Perëndimin vendimin nr. 161, datë 03.04.2024 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele për pozicionet nr. 256, nr. 257 dhe 258 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku është vendosur fillimi i procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për këtë magjistrate.

Me cilësinë e relatorit kam administruar aktet të cilat në përputhje me nenet 8/3, 43/6 do të provonin plotësimin e kritereve formale për vijimin më tej të kandidimit të saj.

Në këtë kuadër kam administruar aktet të cilat provojnë përvojën profesionale specifike.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, znj. {...} ka përfunduar studimet degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 20.07.2012, ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave në “E drejtë civile” pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2014 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019. Me vendimin nr. 8, datë 09.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar. Me vendimin nr. 48, datë 29.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Me vendimin nr. 434, datë 14.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, komandohet në pozicionin ndihmësmagjistrate në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë, për një periudhë deri në datë 20.10.2023. Me vendimin nr. 477, datë 13.09.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, konfirmohet si ndihmësmagjistrate pranë Gjykatës së Lartë dhe i zgjatet afati i komandimit për një periudhë deri në 20.10.2024, ku dhe aktualisht ushtron

funksionin. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 4 vite. Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Lartë, nga verifikimet e kryera rezulton se: “Për ndihmësmagjistrate znj. {...}, e cila është atashuar në Kolegjin Administrativ sipas tabelës të gjeneruar nga sistemi ICMIS bashkëlidhur, gjeni çështjet e relatuara (me datë caktimi, pranimi dhe hedhje studimi) për periudhën 20.05.2021 - 04.04.2024 në total prej 936 çështje administrative dhe 4 çështje civile. Periudha e emërimit të ndihmësmagjistrates është 20.10.2020 por funksionaliteti i ngarkimit të relacionit me emrin e secilit këshilltar ligjor ka filluar në muajin maj 2021. Periudha për të cilën sistemi nuk gjeneron të dhëna është 20.10.2020-15.05.2021.”

Figura e ndihmës magjistratit në njësinë e shërbimit ligjor të Gjykatës së Lartë risi e nenit 34 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” është krijuar me qëllimin ligjor për të ushtruar veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës të Gjykatës së Lartë duke përfshirë: a) analizimin e praktikës gjyqësore përkatëse mbi interpretimin e dispozitave të zbatueshme për çështjet në gjykim; b) analizimin e çështjes dhe përmbledhjen e procedurës; c) kryerjen e detyrave të tjera për përpunimin e çështjes siç kërkohet nga gjyqtari. Dallimi kryesor i kategorisë së ndihmës magjistratëve si magjistratë të komanduar në krahasim me të tjerët qëndron pikërisht tek natyra e shërbimit ligjor që ai ka në përshkrimin ligjor të punës, pasi në dallim nga të tjerët ai është një figurë “quasi” gjyqësore dhe ndihmon gjithashtu edhe në shkëmbimin e përvojave më të mira reciproke në ekspertimin e ligjit.

Pra edhe në këtë kuadër rezulton që kandidatja plotëson minimalisht një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtare në fushën e së drejtës administrative dhe si gjyqtare e komanduar.

Nuk rezulton të ketë masa disiplinore në fuqi apo papajtueshmëri ambientale, kritere të cilat do të ndalonin vijimin e mëtejshëm të konkurrimit të saj. Në këtë kuadër ju kam paraqitur projektin në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në

Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr. 256, nr.257 dhe nr.258, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, fjalën e do zonja Gentiana Muçaj.

Gentiana Muçaj: Unë po e them për të dyja kandidatet, që i kemi edhe në vijim. Unë jam kundër kualifikimit të tyre për shkak se nuk kanë përvojën profesionale në fushën përkatëse dhe konkretisht në fushën administrative. Për mua veprimtaria si magjistrate e komanduar qoftë në Këshill, qoftë në Gjykatën e Lartë, nuk mundet të barazohet dhe nuk mund të prevalojë mbi veprimtarinë që kryen gjyqtari që kryen gjykime administrative. Duke pasur parasysh që edhe gjykimi administrativ është një gjykim i posaçëm që ka një ligj të posaçëm, që është ligji 49/2012 që është edhe ligj procedural edhe ligj material disi, por edhe në fushën materiale që është një fushë shumë e gjerë, që këtë eksperiencë e gëzon vetëm gjyqtari i gjykatës administrative, dhe kjo veprimtari e gjyqtarit të gjykatës administrative, për mua ligji në nenin 43, flet vetëm për përvojën profesionale si gjyqtar. Prandaj unë jam kundër, edhe për {...} edhe për {...}.

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Muçaj!

Ndonjë koleg tjetër?

Po relatori!

Alban Toro: Natyrisht nuk është për polemikë, por më duhet të ndaj opinion të

ndryshëm në lidhje me institutin e komandimit, sidomos në këtë pozicion për të cilin po flasim, figurën e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, e cila siç e kam cituar është një figurë e posaçme “quasi” gjyqësore, sepse bën të gjithë punën që bën gjyqtari, përveç faktit që nuk ka të drejtë të shpallë vendimet. Legjislacioni ka përfshirë këtë institut në standardet më të larta ndërkombëtare të parashikuara për këtë institut dhe njëkohësisht i atashuar me një garanci kushtetuese me të cilën mbron gjyqtarin jo vetëm nga abuzimet tek institucioni tek i cili ai punon dhe nga ai i emërtesës, në rastin konkret KLGJ për çdo ndërprerje, fillim apo mbarim të periudhës së komandimit, e cila është e kufizuar. Përpos kësaj, ndihmësgjyqtari në rastin konkret, siç e thashë, bën të gjithë aktivitetin që bën një gjyqtar normal, përveç faktit të nënshkrimit të vendimit përfundimtar, por gjithsesi kjo nuk e ndalon atë që ai të merret me çdo lloj legjislacioni material, përfshirë edhe dispozitat e procedurës administrative të gjykimit, duke e ndihmuar gjyqtarin përkatës dhe këshilluar, duke ndarë në këtë kuadër edhe eksperiencën përkatëse që ajo ka në raport me të drejtën. Kështu që unë nuk shikoj ndonjë dallim përveç faktit që legjislacioni, jo vetëm në lëvizjen paralele por edhe në ngritjen në detyrë, jo vetëm këtë përvojë e merr të mirëqenë si përvojën e gjyqtarit, pra si përvojë të veçantë të punës së gjyqtarit, por njëkohësisht i jep edhe vlerë të shtuar, që të tregon që është një institut i cili për nga rëndësia prevalon mbi çdo aktivitet tjetër dhe ndihmon gjyqtarin në ngritje në karrierë dhe në vijueshmërinë e karrierës së tij të vazhdueshme. Faleminderit!

Gentiana Muçaj: Atëherë unë nuk jam dakord me atë që tha zoti Toro, sepse veprimtaria e një ndihmësi në Gjykatën e Lartë nuk mundet të barazohet kurrë me veprimtarinë e një gjyqtari, qoftë të shkallës së parë. Nuk mundet. Ndihmësi nuk mban asnjë lloj përgjegjësie. Ndihmësi bën vetëm relacione. Gjyqtari drejton seancën, përballet me njerëzit, jep vendimin në emër të republikës dhe mban përgjegjësi për atë punën që kryen. Kështu që nuk jam dakord. Nuk i barazoj kurrë.

Naureda Llagami: Dakord.

Kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Votim.

Gentiana Muçaj: Kundër.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë kualifikohet kandidatja {...}.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.04.2024)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr.256, nr.257 dhe nr.258, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Alban Toro.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:30 dhe mbaroi në orën 12:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
5. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
6. ***Alban Toro*** (anëtar)
7. ***Markelian Koça*** (anëtar)

8. *Yllka Rupa* (anëtare)

9. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje, zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Illir Rusi*.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje znj. *Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

4. *Rezarta Taushani, Dorina Priifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

5. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*

6. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.*

7. *Edmon Hoxhaj, Birn.*

8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr.256, nr.257 dhe nr.258, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Alban Toro.

Naureda Llagami: Atëherë kalojmë tek projekt-akti tjetër. Sërish është zoti Toro. Shkurtimisht.

Alban Toro: Faleminderit!

Me vendimet nr.256 - nr.258, datë 24.05.2023 KLGJ është vendosur hapja e tre procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative.

Një nga kandidatet është edhe zonja {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, e transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe aktualisht e komanduar si këshilltare ligjore në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Për këtë kandidate janë kryer disa veprime procedurale. Me vendimin nr. 346, datë 27.06.2023 Këshilli ka miratuar listën e kandidatëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim etik dhe profesional dhe për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe znj. {...}.

Me vendimin nr. 258, datë 24.05.2023, për kandidatët që nuk kanë asnjë vlerësim, Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet nr. 256, nr. 257 dhe 258 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor (*Lapsus gjatë relatimit, pasi vendimi i fillimit të procedurës është me vendimin nr. 161, datë 03.04.2024*).

Edhe për këtë kandidate janë administruar aktet të cilat do të provojnë plotësimin e kriterëve të saj, parashikuar në nenet 8/3, 43/6.

Nga informacioni i administruar përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, rezulton se kandidatja znj. {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 05.07.2002, ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master në “Administrim Publik” pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2009 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020. Me vendimin nr. 478, datë 20.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar. Me vendimin nr. 519, datë 27.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Me vendimin nr. 249, datë

09.06.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, komandohet në pozicionin “Drejtor i Departamenti të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë” në Këshillin e Lartë Gjyqësor për një periudhë 3 (tre) vjeçare. Me vendim nr. 253, datë 07.07.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, deklarohet ndryshimi i pikës 1, të vendimit nr. 249, datë 09.06.2021, etj. Me vendimin nr. 42, datë 31.01.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet për shkak të suprimimit të pozicionit, si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 3 vite. Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale të kandidatës konstatohet se ajo ka ushtruar funksionin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, për një periudhë 8-mujore, (tetor 2020 - qershor 2021) si edhe pjesa më e madhe e përvojës nga periudha 21.06.2021 e në vijim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor në pozicionin e jo magjistrates në përgatitjen e projekt-akteve administrative. Në këto rrethana Komisioni vlerëson se për të analizuar përvojën specifike të kandidatës duhet të analizojmë natyrën e aktivitetit të institucionit publik, KLGJ, detyrat funksionale të kryera nga magjistratja në pozicionin e jo magjistrates, si edhe periudhën kohore të ushtrimit të kësaj detyre, e cila përfshin kohën e komandimit. Ky konkluzion bazohet në nenin 53, pika 9 të ligjit 96/2016.

Në vendimin nr. 320/2020 “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, parashikohet se: “6. Për qëllime të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: ...dh) “Lëvizje paralele” nënkupton kalimin e gjyqtarit: ...ii) nga një pozicion i komanduar në një pozicion në një gjykatë të të njëjtit nivel me atë të pozicionit që ka pasur përpara komandimit; f) “Përvojë në pozicionet e komanduara” nënkupton përvojën e veçantë të punës së kandidatit si gjyqtar i komanduar: në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën Kushtetuese, etj. g) “Përvojë profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë” nënkupton përvojën e veçantë të punës së kandidatit në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë të shpallur.

Në këtë kuadër për verifikimin e kriterit të përvojës profesionale në fushën përkatëse të së drejtës të përshtatshme për pozicionin e lirë, relatori kërkoi dhe

administroi informacion dhe dokumentacion nga institucioni ku ka qenë i komanduar. Nga informacioni i administruar marrë për kandidaten rezulton se ajo ka kryer detyrën e Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë si edhe këshilltar ligjor pranë Komisioneve të Përhershme angazhuar në hartimin e projekt-akteve me natyrë normative, kolektive e individuale pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor si dhe përfaqësime në gjykatën administrative të shkallës së parë dhe të apelit.

Neni 147 i Kushtetutës e përcakton Këshillin e Lartë Gjyqësor si organi publik i cili siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor. Si Institucion Publik Këshilli i Lartë Gjyqësor e shpreh vullnetin nëpërmjet akteve administrative individuale apo kolektive të cilat rregullohen për nga forma dhe procedura e nxjerrjes prej Kodit të Procedurave Administrative dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Veprimtaria administrative e këtij organi konkretizohet me hartimin dhe nxjerrjen e këtyre akteve, të cilat janë shfaqje të vullnetit të tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe kanë për qëllim, krijimin, ndryshimin, apo shuarjen e pasojave të caktuara juridike. Këto akte për nga forma apo përmbajtja e tyre janë akte administrative me karakter të mirëfillte individual, ose i drejtohen një numër të pacaktuar subjektesh (kolektive) pasi nxirren në zbatim të një norme të përgjithshme, rregullojnë një/disa çështje të caktuara, i drejtohen një numri të caktuar subjektesh, të cilët kanë kërkuar shprehjen e vullnetit të saj si dhe evidentojnë qartë karakterin shterues të tyre.

Pikërisht në kuadër të ushtrimit të vullnetit të tij organi administrativ është i detyruar që të nxjerrë aktin administrativ i cili duhet të respektojë parimet kushtetuese. Parimet e shtetit të së drejtës të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, “E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit”-(neni 4 i Kushtetutës). Parimi i drejtësisë dhe i paanësisë, në ushtrimin e funksioneve të tij, organi publik trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie. (neni 13 i Ligjit nr.44/2015). Me një natyrë të aktivitetit të pastër administrativ duke shprehur vullnetin nëpërmjet akteve administrative, Këshilli ka qenë i detyruar të integrojë nëpërmjet institutit të komandimit edhe gjyqtarë në burimet e veta njerëzore me qëllim disponimin dhe shkëmbimin e ekspertizës më të mirë ligjore edhe në këtë fushë, konform

nenit 53 të Ligjit për Statusin.

Në këtë rast magjistrati i komanduar ushtron funksionet e një teknikieni të mirëfilltë, duke ruajtur kështu profilin e saj profesional nga njëra anë dhe nga ana tjetër respekton pajtueshmërinë e funksionit me pavarësinë dhe statusin e posaçëm të magjistratit.

Kjo dispozite e përkufizon komandimin e magjistratit si lëvizjen e tij në një pozicion të jo magjistrati në një institucion brenda sistemit të drejtësisë, pozicion i cili është i pajtueshëm me pavarësinë dhe mbajtjen e statusit të tij. Pikërisht lëvizja e përkohshme e magjistratit në një vend pune të një funksioni shtetëror jo magjistrat realizohet nëpërmjet institutit ligjor dhe procedurës së komandimit. Në kuadër të këtij institucioni një rëndësi statuoire dispozita ligjore i ka dhënë edhe përvojës profesionale si një nga komponentët më të rëndësishëm vlerësues. Në lidhje me përvojën, fjalori i gjuhës shqipe, e konsideron si tërësia e njohurive, e shprehive, që fitohet në jetë e në punë.

Ndërkohë Ligji për Statusin (neni 53/9) ka parashikuar se, për efekte të zhvillimit të karrierës, magjistratit të komanduar nga gjykata në institucionin në të cilin magjistrati komandohet, periudha e komandimit i llogaritet si përvojë në profesion në shkallë të parë apo përvoja e magjistratit të komanduar, nga gjykata në shkallë të dytë, në institucionin në të cilin magjistrati komandohet llogaritet si përvojë në profesion në shkallë të dytë.

Më tej në përvoja konsiderohet shumë e rëndësishme edhe kur ndihmësmagjistrati ushtron funksione drejtimi pasi ushtrimi i funksioneve drejtuese në institucionin në të cilin magjistrati komandohet vlerësohet si përvojë drejtuese edhe në gjykatën ku ai konkurron.

Në të njëjtën logjikë favorizuese ligjore legjislatori ka hartuar edhe rregullimet në nenin 47 dhe 48 të këtij ligji. Kështu, në shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 47 parashikohet se, për efekt të ngritjes në detyrë nga magjistrat në gjykatën e ëme të shkallës së parë në gjykatën e ëme të apelit, në periudhën shtatëvjeçare përlllogaritet edhe periudha që magjistrati ka punuar i komanduar. Respektivisht pika 4, 5 dhe 6 e nenit 47 të ligjit parashikon se vjetërsia në punë si magjistrat i komanduar përlllogaritet si vjetërsi edhe për efekt të ngritjes në detyrë, qoftë në gjykatën në shkallë të dytë, për në Gjykatën e Lartë

apo edhe për t'u emëruar si kryetar gjykate.

Në të njëjtën mënyrë neni 43 në pikën 7/a/i ka parashikuar se renditja e magjistratëve në lëvizjen paralele bëhet ndër të tjera duke marrë parasysh dy vlerësimet e fundit të magjistratit të komanduar dhe se në të njëjtën kohë periudha e angazhimit të magjistratëve në pozicionet e komanduara do të konsiderohet si vlerë e shtuar. Pika 3 e nenit 265 të Ligjit Nr. 115/2016 parashikon se magjistratëve të komanduar si pedagogë të brendshëm në Shkollën e Magjistraturës i u njihet si periudhë vjetërsie në punë, si gjyqtarë apo prokurorë, për efekt të kërkesave të karrierës profesionale, të parashikuara në dispozitat ligjore përkatëse.

Për më tepër neni 48 i ligjit parashikon se përvoja e magjistratëve në pozicionet e komanduara do vlerësohet ligjërisht në optikën e organeve përgjegjëse me përparësi në ngritjen në detyrë të tyre në krahasim me kandidatët e tjerë. Ky avantazh theksohet për të dytën herë nga ligji edhe në pikën 3 nenin 57 të këtij ligji, ku parashikohet se: “3. Vetëm në ato raste kur magjistrati ka kryer të gjithë periudhën e komandimit, Këshilli e konsideron me përparësi në lëvizjen paralele ose në procedurat e ngritjes në detyrë”.

Qëllimin e respektimit të vlerësimit të këtij komponenti, përvojën e komandimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor e ka integruar edhe në aktet e vetë normative. Kështu p.sh. Vendimi i KLGJ-së nr. 70, datë 7.2.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, pika 7, germa “f” shprehet se “Përvojë në pozicionet e komanduara”, nënkupton përvojën e veçantë të punës së gjyqtarit si gjyqtar i komanduar: në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën Kushtetuese; në pozicionin e inspektorit... etj.

Mbajtur në vëmendje sa më lart, në përputhje me pikën 9 të nenit 53 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pikën 55 të vendimit 320/2020 të KLGJ-së, arrihet në përfundimin se përvoja apo eksperiencia në fushën përkatëse do të vlerësohet nga burimi i marrëdhënies së punës të krijuar midis tij dhe institucionit ku është komanduar. Natyrisht që përvoja në kuptim të ligjit do të rezultojë nga natyra e punës dhe kontributit të magjistratit në institucionin e komanduar e cila duhet të jetë e vazhduar dhe jo sporadike në përputhje me afatin e plotë të caktuar për

tu komanduar në të. Analiza e aktivitetit të institucionit të mundëson në identifikimin e fushës ku magistrati ka kontribuar dhe si rrjedhim dhe përvojën përkatëse minimale, (neni 47/4 – përvojë 5 në 7 ose neni 43/ 6 i Ligjit për Statusin, ku rezulton evidentimi i përvojës 1 në 5), të përfituar për shkak të këtij aktiviteti. Interpretimi i ndryshëm i këtyre parashikimeve ligjore do të bënte të pamundur përlogaritjen e eksperiencës së magistratit të komanduar në Këshilla, Ministrinë e Drejtësisë, Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut etj., institucione të tilla që nuk lidhen ngushtë me një lëndë të caktuar të së drejtës, por përfshijnë disa degëzime të saj.

Për më tepër eksperiencia e magistratit të komanduar, pavarësisht se ku është ushtruar detyra është konsideruar si eksperiencë e ëme për secilin pozicion të lirë të përhershëm që ka kërkuar si kriter procedura e lëvizjes paralele apo ngritja në detyrë duke u formalizuar me vendimmarrjet përkatëse të cilat aktualisht për shkak të pasojave të krijuara kanë formësuar edhe sigurinë juridike në këtë drejtim. Parimi i sigurisë juridike mbron garancitë që rrjedhin nga neni 138 i Kushtetutës, ku përfshihet edhe e drejta e karrierës, si pjesë përbërëse e statusit të gjyqtarit dhe një nga përfitimet e tjera që gjyqtarët gëzojnë për shkak të funksionit. Qëllimi i parimit të sigurisë juridike është të sigurojë besimin e personave të shteti e ligji dhe vetë gjyqtarët, të cilët administrojnë drejtësinë, duhet të gëzojnë një besim të tillë. Në këtë kontekst citoj vendimin nr.11, datë 06.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

Duke iu kthyer analizës së vendimmarrjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku në shumë projekte të tyre janë pasqyrim i kontributit të kandidatës, të tilla si projekt-vendimesh për zhvillim karriere gjyqtaresh, projekt-rregullore, projekt-udhëzime të cilat rregullohen në mënyrë të ëme nga Kodi i Procedurave Administrative, ligji 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligji 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ligji 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe janë akte administrative apo legjislacione të tjera rezulton se përvoja e përfituar në këtë fushë do të duhet të konsiderohet si administrative.

Kohëzgjatja e komandimit të kandidatës për më shumë se 2.5 vjet pranë Këshillit

në një fushë tipike administrative përfshin jo vetëm afatin kohor të përcaktuar në nenin 43 pika 6 të Ligjit Për Statusin, por edhe parashikimet e përvojës minimaliste dhe kriteret e emërimit të magjistratëve të sapo diplomuar dhe integritit të tyre në Gjykatën e Juridiksionit të veçantë, atë administrative. Pika 5, e nenit 39, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve”, përcakton se: “I emëruari që caktohet në pozicion në gjykatat administrative, duhet të ketë përvojë pune në të paktën një vit e gjysmë në administratën publike ose të ketë rezultate "shumë të mira" në lëndët e së drejtës administrative në Shkollën e Magjistraturës”. Në fakt znj. {...} si magjistrate e komanduar në Këshillin Lartë Gjyqësor ka përvojë pune, në këtë Institucion, dy vjet deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për procedurën në lëvizjes paralele.

Pra edhe në këtë kontekst kandidatja në fjalë ka plotësuar kriterin e përvojës specifike.

Nuk rezulton të ketë masë disiplinore apo kushte të tjera të papajtueshmërisë ambientale të cilat do të pengonin konkurrimin e mëtejshëm të saj. Në këtë kuadër ju kam propozuar projektin në dispozitivin e të cilit do të gjeni:

1. Kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr. 256, nr.257 dhe nr.258, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Toro!

Atëherë nëse s’kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Gentiana Muçaj: Kundër.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord, si me relacionin ashtu edhe me propozimet që bëri kolegu. Ishte i mjaftueshëm, i bollshëm dhe bindës. Faleminderit!

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga relatori.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.04.2024)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit:

11.1 Mbi miratimin e “Rregullores për formimin profesional të nëpunësve civilë gjyqësorë”.

11.2 Mbi miratimin e “Planit Strategjik 2024-2025 për trajnimin fillestar dhe vazhdues të nëpunësve civilë gjyqësorë”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:30 dhe mbaroi në orën 12:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Irena Plaku*** (anëtare)
- 5. Gentiana Muçaj*** (anëtare)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)

7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)
10. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje, zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Illir Rusi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
4. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
6. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
7. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.*
8. *Edmon Hoxhaj, Birn.*
9. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtim i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit:

11.1 Mbi miratimin e “Rregullores për formimin profesional të nëpunësve civilë gjyqësorë”.

11.2 Mbi miratimin e “Planit Strategjik 2024-2025 për trajnimin fillestar dhe vazhdues të nëpunësve civilë gjyqësorë”.

Naureda Llagami: Tani kemi tre akte që janë bërë nga Komisioni i Administrimit të Buxhetit.

Në fakt, siç e përmenda pak gjatë relatimit të raportit vjetor, sot kemi në rend dite tre akte të cilat janë shumë të rëndësishme, që plotësojnë të gjithë paketën e akteve nënligjore për nëpunësin gjyqësor civil. Kemi edhe një akt tjetër që do e sjellim javës tjetër, por me këto akte, le të themi, përfundon komplet paketa ligjore dhe për këtë në fakt falënderoj shumë komisionin për punën dhe dedikimin. Drejtoreshën që ka ardhur këtu, gjithashtu edhe projektet që na kanë asistuar në hartimin e këtij seti aktesh, që janë projektet që asistojnë Këshillin (projekti i Ambasadës Amerikane por gjithashtu edhe Këshilli i Evropës), të gjithë bashkëpunëtorët tanë që na kanë ndihmuar.

Kështu, ku konsistojnë këto akte? Kemi propozuar një Plan Strategjik për vitin 2024-2025 për trajnimin fillestar dhe vazhdues të nëpunësve civilë gjyqësorë. Pra për herë të parë edhe nëpunësit civilë gjyqësorë tashmë pasi rekrutohen do i nënshtrohen një trajnimi fillestar që do bëhet nga Sektori i Trajnimeve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Gjithashtu kemi edhe trajnimin e vazhduar që për çështje të caktuara do të kemi një kalendar kur do parashikohet një trajnim. Jo se kjo gjë nuk bëhet nga stafi i Këshillit, të paktën me dijeninë time si Kryetare, shpeshherë mbledhen për çështje të cilat kanë interes, ndryshime ligjore nga stafi, por ajo punë që ne deri më sot e kemi bërë në një mënyrë jo formale, atëherë ne po i japim një formalitet ashtu siç në fakt e kërkon edhe ligji.

Këtu përpara kam Drejtoreshën e Departamentit të Burimeve Njerëzore, e cila do japë shkurtimisht prezantim të tre akteve. Fillojmë me Planin Strategjik si dokument strategjik. Më pas me rregulloren për formimin profesional të nëpunësve gjyqësorë. Dhe e fundit në përcaktimin e tarifave për trajnerët, ekspertët lehtësues që do marrin pjesë në këto trajnime. Dhe në mbledhjen e ardhshme do të propozojmë aktin tjetër, i fundit që është në këtë lloj pakete. Faleminderit!

Për mua fjalën e ka znj. Petriti.

Etrita Petriti: Faleminderit!

Të nderuar!

Siç u theksua edhe nga Kryetarja, janë përgatitur projektvendimet, fillimisht Plani Strategjik 2024-2025 për trajnimin fillestar dhe vazhdues të nëpunësve civilë gjyqësorë. Akti synon të mbështesë zhvillimin e një program trajnimi profesional të cilësisë së lart në shërbimin civil gjyqësor. Përshkruan kompetentët e edukimit standard të gjykatave mbledhur nga një analizë e përvojave në sistemet e tjera gjyqësore gjatë dekadave të fundit. Ky Plan Strategjik do të ndihmojë Këshillin e Lartë Gjyqësor në zhvillimin e programit të trajnimit dhe do të orientojë masat për ngritjen e kapaciteteve të Njësisë së Trajnimit pranë KLGJ-së. Gjithashtu Plani Strategjik për programin e trajnimit profesional të shërbimit civil përmban dokumentet duke i ndarë në shtojca:

Shtojca A - Vështrim përmbledhës i prioriteteve strategjike;

Shtojca B - Kalendari i Trajnimit 2024- 2025;

Shtojca C – Matrica e Trajnimit Vazhdues;

Shtojca D – Analiza e Qasjeve ndaj Edukimit.

Bashkëlidhur këtij draft plani strategjik është i gjithë dokumentacioni (shtojcat) të cilat do të vihen në dispozicion të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore për marrjen e masave dhe zhvillimin e trajnimeve profesional të nëpunësve civilë gjyqësorë.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Ndonjë pyetje?

Pyetja që ka zoti Kurushi është për pjesën e formimit: A do involvohen edhe këshilltarët ligjorë dhe ndihmësit ligjorë, dhe kancelarët, apo do jetë ekskluzivitet i Shkollës për ta bërë këtë gjë?

Etrita Petriti: Të nderuar!

Rregullorja për trajnimin ka përmbledhur kategorinë e nëpunësve civilë duke përjashtuar kancelarë, këshilltarë dhe ndihmës ligjorë.

Naureda Llagami: Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në miratimin e këtij dokumenti strategjik.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet Plani Strategjik 2024-2025 për trajnimin fillestar dhe vazhdues të nëpunësve civilë gjyqësorë sipas tekstit bashkëlidhur.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Naureda Llagami: Kalojmë tek rregullorja për formimin profesional të nëpunësve civilë gjyqësorë. Në hartimin e kësaj rregulloreje janë mbajtur parasysh edhe standardet që ka Shkolla e Magjistraturës por edhe administrata publike. Kështu që po ia jap sërish fjalën drejtoreshës për ta relatuar shkurtimisht.

Etrita Petriti: Faleminderit!

Të nderuar!

Projektvendimi i paraqitur për miratim është një akt nënligjor i cili në përputhje me parimet në të cilat mbështetet shërbimi civil gjyqësor dhe veçanërisht me detyrimin që buron nga kuadri ligjor për krijimin e një administrate gjyqësore me nivel të lartë profesionalizmi, integriteti, dhe të orientuar drejt shërbimeve efçente dhe të aksesueshme për çdo person. Draft rregullorja trajton programin e formimit fillestar për nëpunësit

civilë në periudhë prove, dhe programin e formimit të vazhdueshëm për nëpunësit civilë tashmë të konfirmuar në detyrë.

Projektvendimi është hartuar nga grupi i punës gjithashtu në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë.

Gjithashtu këtij materiali i bashkëngjiten edhe module të specifikuara:

- Qëllimet e Gjykatave dhe Përgjegjësitë
- Etika
- Menaxhimi i burimeve njerëzore
- Buxheti dhe Financa
- Teknologjia e informacionit
- Marrëdhëniet me Publikun
- Statistikat
- Shkrimi dhe Arsyetimi Ligjor
- Arkivat Gjyqësore
- Planifikimi Strategjik

Pra rregullorja ka për qëllim rregullimin e mënyrës se si do të zhvillohet formimi i nëpunësve civilë gjyqësorë. Pra qëllimi i kësaj rregulloreje përveçse në zbatim të ligjit 115/2016 i ndryshuar, ligjit 98/2016, i ndryshuar, vjen në përputhje edhe me Planin Strategjik.

Parashikimet e kësaj Rregulloreje do të jenë të zbatueshme gjatë programit të formimit fillestar dhe vazhdues të kategorive të nëpunësve: kryesekretar; sekretar gjyqësor; nëpunës që punojnë në fushat e kërkimit ligjor dhe të dokumentacionit; nëpunës i buxhetit dhe financës; nëpunës të marrëdhënieve publikun, me jashtë ose me median; nëpunës i burimeve njerëzore; nëpunës së teknologjisë dhe informacionit; nëpunës të arkivit.

Programi i Formimit Fillestar është i detyrueshëm për nëpunësit civilë gjyqësorë në periudhë prove, për një kohë të paktën 2 javë.

Programi i Formimit Vazhdues garanton krijimin dhe ruajtjen e një administrate gjyqësore me aftësi të larta profesionale dhe etike.

Rregullorja do të vihet në zbatim në përputhje me Planin Strategjik 2024-2025 për formimin fillestar dhe vazhdues të nëpunësit civil gjyqësor. Gjithashtu do të vihet në zbatim nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me gjykatat, Shkollën e Magjistraturës dhe partnerët ndërkombëtarë.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit i cili shoqërohet, e keni vënë re me të gjithë modulet.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi:

Miratimin e “Rregullores për formimin profesional të nëpunësve civilë gjyqësorë” sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.04.2024)

Pika 12 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi përcaktimin e tarifave për trajnerë/ ekspertë e lehtësues, që do të ofrojnë programin e formimit fillestar dhe vazhdues për nëpunësit civil gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:30 dhe mbaroi në orën 12:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Klodian Kurushi* (anëtar)
3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Irena Plaku* (anëtare)
5. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Markelian Koça* (anëtar)

9. Yllka Rupa (anëtare)

10. Emona Muçi (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje, zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Illir Rusi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.

4. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

6. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.

7. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.

8. Edmon Hoxhaj, Birn.

9. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

12. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi përcaktimin e tarifave për trajnerë/ ekspertë e lehtësues, që do të ofrojnë programin e formimit fillestar dhe vazhdues për nëpunësit civil gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë edhe tek akti tjetër i cili është pjesë përbërëse e këtij seti aktesh, që ka të bëjë me mbi përcaktimin e tarifave për trajnerë/ekspertë e lehtësues që do të ofrojnë programin e formimit fillestar dhe vazhdues për nëpunësit civilë

gjyqësorë. Sërish prapë fjalën e ka znj. Petriti.

Etrita Petriti: Faleminderit e nderuar!

Vendimi për caktimin e tarifave të trajnimit për trajnerë/ekspertë/lehtësues është një akt që merret në kuadër të jetësimit të Rregullores për formimin profesional të nëpunësve civilë gjyqësorë.

Grupi i punës ka marrë në analizë dhe sipas kërkimeve rezultoi se VKM nr.138, datë 12.03.2014 “Për rregullat e organizimit e të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe trajnimin e nëpunësve civilë” ka të përcaktuara hollësisht tarifatat për trajtimin e trajnerëve/ekspertëve/lehtësuesve.

Referenca në këtë VKM, u pa e arsyeshme për t’u përdorur edhe për trajtimin financiar të trajnerëve mbi rregulloren e miratuar nga KLGJ-ja.

Për trajtimin financiar të tyre, trajnerët/eksperte/lehtësues, janë ndarë në tre kategori:

- a) kategoria e lartë,
- b) kategoria e mesme,
- c) kategoria e ulët.

Ndarja e trajnerëve në këto kategori mbështetet në nivelin e kualifikimit dhe vjetërsinë në profesion të cilat janë të specifikuara edhe në projektvendim. E njëjta ndarje vlen edhe për ekspertët dhe lehtësuesit. Gjithashtu projektvendimi përmban edhe tabelën me masën e pagesës për orë trajnimi.

Alokimi i buxheteve të nevojshme për zbatimin e Rregullores së formimit profesional të nëpunësve civilë gjyqësorë, garanton suksesin në fillimin dhe vijimësinë e procesit për “krijimin e një administrate gjyqësore me kapacitete të larta profesionale dhe etike, në funksion të dhënies së drejtësisë dhe rritjes së besimit të publikut në sistemin gjyqësor”.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim?

Atëherë, unë kisha një pyetje.

Të gjithë këto tarifa do fillojnë buxhetimin me buxhetin për 2024-2025? Pra parashikimi është në 2024, për 2025.

Faleminderit!

Atëherë kalojmë në miratimin e projekt-aktit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi:

Miratimin e projektvendimit për përcaktimin e tarifave për trajnerë/ ekspertë/ lehtësues që do të ofrojnë programin e formimit fillestar dhe vazhdues për nëpunësit civilë gjyqësorë.

* * *

(Pika 12 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.04.2024)

Pika 13 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarët pjesë e programit të vlerësimeve për vitin 2024”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Emona Muçi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:30 dhe mbaroi në orën 12:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Markelian Koça*** (anëtar)

9. Yllka Rupa (anëtare)

10. Emona Muçi (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje, zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Illir Rusi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

4. Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.

6. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.

7. Edmon Hoxhaj, Birn.

8. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

13. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarët pjesë e programit të vlerësimeve për vitin 2024”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Emona Muçi).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve pjesë e programit të vlerësimeve për vitin 2024. Përpara se t’ia jap fjalën relatores, i bëj thirrje administratës që të bëjë gati procedurën e shortit.

Fjala është për zonjën Muçi.

Emona Muçi: Atëherë në lidhje me relacionin për miratimin e projektvendimit për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarët pjesë e programit të vlerësimeve për vitin 2024.

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 18, datë 18.01.2024 ka miratuar “Programin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2024”, duke përfshirë në program 37 gjyqtarë, si dhe duke përcaktuar prioritetet e planifikimeve 4-mujore.

Sa i përket përcaktimit të gjyqtarëve që do të përfshihen në programin e parë 4-mujor për vitin 2024, Komisioni ka pasur në vëmendje vendimin nr.127, datë 11.03.2024 ku është miratuar lista e gjyqtarëve mund të kenë një vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, në zbatim të nenit 85 dhe 97 të Ligjit për Statusin, vendimit nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe vendimit nr.18, datë 18.01.2024, me qëllim realizimin e programit të miratuar të vlerësimeve etike dhe profesionale për vitin 2024, i propozon mbledhjes plenare, fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2020-2022 për 5 gjyqtarë, të cilët kanë ushtruar detyrën në periudhën e vlerësimit 2020-2022 dhe fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2021-2023 për 9 gjyqtarë, të cilët kanë ushtruar detyrën në periudhën e vlerësimit 2021-2023, konkretisht:

Periudha e vlerësimit 2020-2022: znj.{...}, z.{...}, z.{...}, znj {...}, z.{...};

Periudha e vlerësimit 2021-2023: 1. z. {...}, 2. znj.{...}, 3.znj.{...}, 4.znj.{...}, 5. z.{...}, 6. znj.{...}, 7. z.{...}, 8. z.{...}, 9. z.{...}. Të cilët në relacion janë përshkruar dhe gjykatat pranë të cilës ushtrojnë aktualisht funksionet.

Procesi i vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2020-2022 dhe 2021-2023 do të zhvillohet mbi bazën e burimeve të vlerësimit të përcaktuara në nenin 77 të Ligjit për Statusin, rregullave të përcaktuara në nenet 71 e vijues të këtij ligji dhe

vendimeve të KLGJ nr.263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr.264, datë 21.11.2019 “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit”.

Për sa më lart, mbështetur në dispozitat ligjore që është bazuar kjo vendimmarrje, ky Komision ka përgatitur projektvendimin në lidhje me fillimin e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarët pjesë e programit të vlerësimeve për vitin 2024 dhe konkretisht:

Në pikat I dhe III të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2020-2022 për 5 gjyqtarë dhe për periudhën e vlerësimit 2021-2023 për 9 gjyqtarë, të cilët janë pjesë e programit të vlerësimeve për vitin 2024.

Në pikat II dhe IV të projektvendimit përcaktohet caktimi i relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për gjyqtarët subjekt vlerësimi, proces i cili realizohet nëpërmjet shortit midis anëtarëve të përhershëm dhe anëtarit gjyqtar zëvendësues të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale për relatorin, dhe ndërmjet tre nëpunësve të Njesisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional, sipas nenit 12 pika 2 të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263.

Lidhur me procedurën e shortit që do të zhvillohet për përzgjedhjen e relatorit për secilin gjyqtar për të cilën duhet të fillojë procedura e vlerësimit, duke marrë në konsideratë ngarkesën aktuale të punës të anëtarëve të komisionit, Komisioni i propozon mbledhjes plenare, që në procedurë të marrin pjesë 3 anëtarët e përhershëm znj. Emona Muçi, znj.Irena Plaku dhe znj. Yllka Rupa, si dhe të përfshihet në short anëtari gjyqtar zëvendësues znj. Gentiana Muçaj, sipas vendimit nr. 742, datë 26.12.2023.

Në procedurën e shortit që do të zhvillohet për përzgjedhjen e relatorit për secilin gjyqtar, do të përfshihen znj. Emona Muçi, znj.Irena Plaku znj.Yllka Rupa dhe znj. Gentiana Muçaj, duke u bazuar në barazinë e shpërndarjes së ngarkesës së punës dhe duke vlerësuar që të shortohen 4 (katër) procedura vlerësimi për anëtarët Emona Muçi dhe Gentiana Muçaj dhe nga 3 (tre) për anëtarët Yllka Rupa dhe Irena Plaku. Në lidhje me numrin e nëpunësve përgjegjës që do të angazhohen, do të jenë nëpunësit përgjegjës

znj.Merita Karaj dhe znj.Erlanda Agaj, me një ngarkesë prej 5 (pesë) vlerësime dhe znj. Anjeza Buzo, me 4 (katër) procedura vlerësimi.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë ftoj administratën e cila do bëjë procedurën e shortit.

Procedura e shortit si vijon:

Në enën e parë të qelqit futen me radhë shiritat e letrës me emrat e gjyqtarëve: znj.{...}, z.{...}, z.{...}, znj {...}, z.{...}, z. {...}, znj.{...}, znj.{...}, znj.{...}, z.{...}, znj.{...}, z.{...}, z.{...}, z.{...}.

Në enën e dytë të qelqit futen me radhë shiritat e letrës me emrat e relatorëve: znj. Emona Muçi (katër shirita), Gentiana Muçaj (katër shirita), Irena Plaku (tre shirita), Yllka Rupa (tre shirita).

Në enën e tretë të qelqit futen me radhë shiritat e letrës me emrat e nëpunësve përgjegjës për vlerësimin: znj.Merita Karaj (pesë shirita), znj.Erlanda Agaj (pesë shirita), znj.Anjeza Buzo (katër shirita).

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Përzgjidhet emri i parë i gjyqtarit, znj. {...} (periudha e vlerësimit 2020-2022). Relator përzgjidhet znj. Irena Plaku dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Merita Karaj.

Përzgjidhet emri i dytë i gjyqtarit, znj. {...} (periudha e vlerësimit 2021-2023). Relator përzgjidhet znj. Gentiana Muçaj dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Erldanda Agaj.

Përzgjidhet emri i tretë i gjyqtarit, z. {...} (periudha e vlerësimit 2021-2023). Relator përzgjidhet znj. Gentiana Muçaj dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Erldanda Agaj.

Përzgjidhet emri i katërt i gjyqtarit, znj. {...} (periudha e vlerësimit 2020-2022).
Relator përzgjidhet znj. Emona Muçi dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Merita Karaj.

Përzgjidhet emri i pestë i gjyqtarit, z. {...} (periudha e vlerësimit 2021-2023).
Relator përzgjidhet znj. Yllka Rupa dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Anjeza Buzo.

Përzgjidhet emri i gjashtë i gjyqtarit, z. {...} (periudha e vlerësimit 2020-2022).
Relator përzgjidhet znj. Irena Plaku dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Merita Karaj.

Përzgjidhet emri i shtatë i gjyqtarit, znj. {...} (periudha e vlerësimit 2021-2023).
Relator përzgjidhet znj. Emona Muçi dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Merita Karaj.

Përzgjidhet emri i tetë i gjyqtarit, z. {...} (periudha e vlerësimit 2021-2023).
Relator përzgjidhet znj. Emona Muçi dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Erlanda Agaj.

Përzgjidhet emri i nëntë i gjyqtarit, z. {...} (periudha e vlerësimit 2021-2023).
Relator përzgjidhet znj. Gentiana Muçaj dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Erlanda Agaj.

Përzgjidhet emri i dhjetë i gjyqtarit, znj. {...} (periudha e vlerësimit 2021-2023).
Relator përzgjidhet znj. Emona Muçi dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Anjeza Buzo.

Përzgjidhet emri i njëmbëdhjetë i gjyqtarit, z. {...} (periudha e vlerësimit 2020-2022).
Relator përzgjidhet znj. Gentiana Muçaj dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Erlanda Agaj.

Përzgjidhet emri i dymbëdhjetë i gjyqtarit, znj. {...} (periudha e vlerësimit 2021-2023).
Relator përzgjidhet znj. Irena Plaku dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Anjeza Buzo.

Përzgjidhet emri i trembëdhjetë i gjyqtarit, z. {...} (periudha e vlerësimit 2020-2022).
Relator përzgjidhet znj. Yllka Rupa dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Merita Karaj.

Përzgjidhet emri i katërbëdhjetë i gjyqtarit, z. {...} (periudha e vlerësimit 2021-

2023). Relator përzgjidhet znj. Yllka Rupa dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Anjeza Buzo.

Naureda Llagami: Atëherë, hedhim në votim projekt-aktin?

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit 2020-2022, për 5 (pesë) gjyqtarë pjesë e programit të vlerësimit për vitin 2024.

2. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:

Për gjyqtaren znj. {...} - Relatore znj. Emona Muçi - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Merita Karaj;

Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Irena Plaku - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Merita Karaj;

Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Gentiana Muçaj - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Erlanda Agaj;

Për gjyqtaren znj. {...} - Relatore znj. Irena Plaku - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Merita Karaj;

Për gjyqtarin z. {...} - Relatore znj. Yllka Rupa - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Merita Karaj.

3. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit 2021-2023, për 9 (nëntë) gjyqtarë pjesë e programit të vlerësimit për vitin 2024.

4. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:

Për gjyqtarin z.{...} - Relatore znj. Emona Muçi - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Erlanda Agaj;

Për gjyqtaren znj.{...} – Relatore znj. Emona Muçi - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Merita Karaj;

Për gjyqtaren znj.{...} – Relatore znj. Irena Plaku - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Anjeza Buzo;

Për gjyqtaren znj.{...} - Relatore znj. Emona Muçi - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Anjeza Buzo;

Për gjyqtarin z.{...} - Relatore znj. Gentiana Muçaj - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Erlanda Agaj;

Për gjyqtaren znj.{...} - Relatore znj. Gentiana Muçaj - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Erlanda Agaj;

Për gjyqtarin z.{...} - Relatore znj. Gentiana Muçaj - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Erlanda Agaj;

Për gjyqtarin z.{...}- Relatore znj. Yllka Rupa - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Anjeza Buzo;

Për gjyqtarin z.{...} - Relatore znj. Yllka Rupa - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Anjeza Buzo.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 13 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.04.2024)

Pika 14 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2023, për gjyqtaren {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Emona Muçi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:30 dhe mbaroi në orën 12:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Markelian Koça*** (anëtar)

9. Yllka Rupa (anëtare)

10. Emona Muçi (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje, zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Illir Rusi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

4. Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.

6. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.

7. Edmon Hoxhaj, Birn.

8. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

14. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2023, për gjyqtaren {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Emona Muçi).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër. Edhe ky është një projekt-akt për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar për vlerësimin etik dhe profesional, viti kalendarik 2023, për gjyqtaren {...}.

Emona Muçi: Në lidhje me relacionin e fundit.

Për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës janë hapur vendet për këto lëvizje dhe është bërë edhe lista që janë përfshirë gjyqtarët që mund të kenë dy vlerësime, ku ndërmjet të tjerash ka qenë edhe zonja {...}.

Në relacion, nga ana e Komisionit është bërë arsyetimi në lidhje për secilin prej gjyqtarëve, konkretisht për gjyqtarët z. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, të cilët mund të rezultojnë me dy vlerësime.

Ndërkohë që në lidhje me gjyqtaren {...} e cila është vlerësuar nga ana e Komisionit që mund të ketë dy vlerësime. Në lidhje me vlerësimin e parë, rezulton se me vendimin nr. 370, datë 13.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur mosfillimi i procedurës së vlerësimit për periudhën 2013-2016 (gradimit) për shkak se koha e ushtrimit të detyrës, brenda periudhës së vlerësimit, ishte më e shkurtër se një vit. Në kushtet kur kjo gjyqtare e ka kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar dhe është konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë, vlerësim i parë do konsiderohet ai 3-vjeçar 2017-2019 i cili ka filluar dhe është në proces si pjesë e programit të vlerësimeve periodike për periudhën 2017-2019. Ndërsa vlerësim i dytë për këtë gjyqtare do të konsiderohet vlerësimi i përshpejtuar i detyruar i vitit të fundit kalendarik 2023, për shkak të kandidimit në lëvizje paralele nga ana e kësaj gjyqtareje.

Bazuar sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, vlerëson se në kushtet kur gjyqtarja {...} me vendimin nr.189, datë 09.04.2024 është kualifikuar në procedurën e lëvizjes paralele në gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë e Durrës, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 74, nr. 82 dhe nr. 83, datë 20.02.2024, Këshilli duhet të fillojë me përparësi procedurën e përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtaren {...}, e cila ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit që përfshin vitin e fundit kalendarik, përkatësisht vitin 2023.

Procesi i vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 1 janar 2023-31 dhjetor 2023 do të zhvillohet mbi bazën e burimeve të vlerësimit të përcaktuara në nenin 77 të Ligjit për Statusin, mbi bazën e rregullave [...].

Në pikën I të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional për vitin kalendarik 2023, për gjyqtaren {...}.

Në pikën II të projektvendimit përcaktohet caktimi i relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për gjyqtaren {...}, proces i cili do të realizohet nëpërmjet shortit midis anëtarëve të Komisionit znj.Emona Muçi, znj.Yllka Rupa dhe znj.Irena Plaku për relatorin dhe ndërmjet tre nëpunësve të Njesisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional znj.Erlanda Agaj, znj.Merita Karaj dhe znj.Anjeza Buzo.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë stafi të hedhi shortin.

Procedura e shortit si vijon:

Në enën e parë të qelqit vendoset shiriti i letrës me emrin e kandidatës znj. {...}.

Në enën e dytë të qelqit vendosen shiritat e letrës me emrat e relatorëve znj. Emona Muçi, znj. Irena Plaku dhe znj. Yllka Rupa.

Në enën e tretë të qelqit vendosen shiritat e letrës me emrat e nëpunësve përgjegjës znj. Anjeza Buzo, znj. Erlanda Agaj, znj. Merita Karaj.

Procedura e përzgjedhjes:

Për kandidaten znj. {...}, përzgjidhet relatore znj. Irena Plaku dhe nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Erlanda Agaj.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votim?

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2023, për gjyqtaren {...}.
2. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për gjyqtaren znj. {...} - Relator znj. Irena Plaku - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Erlanda Agaj.

Naureda Llagami: Me kaq po e mbyllim mbledhjen për sot.

Rikujtesë, nesër mbledhja në orën 13:00 për të shqyrtuar projektbuxhetin. Mbledhja është hibride, nëse doni të jeni online, mund të jeni edhe prezent. Kështu që, si ta vlerësoni ju. Duke qenë se është një projekt-akt që ne e kemi konsultuar.

Faleminderit!

* * *

(Pika 14 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor